




Koha



EDITORIAL

Demografia dhe autok- tonia



Demografia duhet përfundimisht të del nga kthetrat e politikës. Paralajmërimi për një regjistrim të ri të popullsisë në vitin 2010 duhet përfundimisht të mbyll disa tema që artificialisht hapen. Maqedonia është e vogla për gjithë këtë konspiracion të madh rreth strukturës demografike. Fundja, statistika e popullsisë nuk është vetëm një grumbull numrash, por edhe politikë planifikimi dhe zhvillimi. Deri më tani janë mbajtur disa regjistrime të popullsisë, por gjithmonë ka pasur dilema nëse parametrat e përlogaritjes...

Fq.2

GLOBI

Arrestohet biznesmeni që komplotoi vrasjen e gazetarit rus

Fq.17

FORUM

Reformat?!

Fq.11



BRENDIMI RRIT EDHESHITJEN, OEMVP E GATSHME TË NDIHMOJË

DIASPORA HAP DYERT E EKSPORTIT



Në Maqedoninë perëndimore nuk mungojnë prodhues të suksesshëm që shesin jashtë e të cilëve dyert e Evropës ua ka hapur diaspora. Megjithatë, kriza politike ka ndikuar që edhe kompanitë shqiptare në një pjesë të madhe të orientohen më shumë në stabilizim dhe jo në zgjerimin e biznesit drejt eksportit jashtë vendit

Fq.6

Në pritje të transformimit të vendit të punës

Shkup, 1 qershor - Shumë mësues e arsimtarë, të cilët japin mësim prej më tepër se pesë vite, nuk e kanë të rregulluar ende siç duhet statusin e tyre të vendit të punës. Edhe pse sipas Ligjit për marrëdhënie pune, do të duhej që të gjithë ata që janë të punësuar në arsim pas tre viteve angazhim të pandërprerë në një shkollë të caktuar të gëzojnë të drejtën e punësimit me afat të pacaktuar kohor, konkretisht me marrëdhë-

nie të rregullt pune, prapë se prapë një numër i konsiderueshëm i tyre detyrohen të nënshkruajnë kontrata pune me afat të caktuar gjatë çdo fillimi të ri të vitit shkollor. Sindikata e Arsimin, Shkencës dhe Kulturës fajëson për këtë situatë gjykatat të cilat sipas kryetarit të SASHK-ut, Jakim Nedellkov, janë selektive në marrjen e vendimeve. Nga viti 2009 e deri në mars të 2017-ës është realizuar...

Fq.5



EDITORIAL

DEMOGRAFIA
DHE AUTOKTONIA

Emin AZEMI

Demografia duhet përfundimisht të del nga kthetrat e politikës. Paralajmërimi për një regjistrim të ri të popullsisë në vitin 2010 duhet përfundimisht të mbyll disa tema që artificialisht hapen. Maqedonia është e vogla për gjithë këtë konspiracion të madh rreth strukturës demografike. Fundja, statistika e popullsisë nuk është vetëm një grumbull numrash, por edhe politikë planifikimi dhe zhvillimi. Deri më tani janë mbajtur disa regjistrime të popullsisë, por gjithmonë ka pasur dilema nëse parametrat e përllogaritjes demografike ka qenë në përputhje me strukturën etnike.

Shqetësimi që vjen nga demografia e ngatërruar e "maltusëve" modern, sërish po projektohet gabimisht mbi teori e supozime për numrin e shqiptarëve në Maqedoni. Ata duan që shqiptarë këtu të ketë sa më pak, në mënyrë që fuqia vendimarrëse e tyre të marginalizohet dhe të reduktohet në përmasat e një grupi etnik pa ndikim faktorizues. Por, demografia si shkencë është më kokëfortë se teoritë maltusiane.

Çuditërisht, kontestimi i shqiptarëve si etni vjen gjithmonë nga ata që kanë probleme me identitetin e tyre dhe zelli për të prejdukuar shifra që minimizojnë faktorin shqiptar, në fakt fshehin një të vërtetë që ata nuk duan ta pranojnë publikisht. Ata, duke u marrë me, gjoja, parëndësinë demografike të shqiptarëve si numër që qenka në nivele të ulëta, po mundohen të fshehin boshatisjen e fshatrave e qytetave të tëra në Maqedoninë Lindore dhe ky është një proces që askush nuk mundet ta ndalë dhe më së paku me propagandë bajate.

Maqedonia si shtet ende nuk e ka një strategji demografike e më së paku nuk ka mekanizma që do ta vinte nën kontroll lëvizjen e popullsisë.

Tani, jetojmë në një kohë kur sërish numri i shqiptarëve paraqet problem, gjithmonë me bindjen se gjoja shqiptarët janë më pak se sa që thonë statistikat zyrtare. Duke rënë kollaj në kurthet që i ngrenë vetë ata, këta "maltusë" po duan të dinë saktësisht se sa shqiptarë, sa maqedonas dhe sa të tjerë jetojnë në Maqedoni dhe në bazë të këtyre parametrave demografikë do të përkufizoheshin edhe të drejtat politike.

Vazhdimisht është aluduar në 20 përqindëshin, një shifër e zbuluar kjo që ka shërbyer si gurë kilometrikë që ndanë dy shpejtësitë e jetës politike në Maqedoni. Fatkeqësisht nën kurthin e këtij 20 përqindëshi kanë rënë edhe faktorët politikë shqiptarë, tash e disa vite, duke mos arritur të bëjnë një diferencim të qartë në mes të termave statistikore dhe politikë, në mes të demografisë dhe autoktonisë.

Nëse një popull autokton, siç janë shqiptarët, trajtohet vazhdimisht me produktet maltusiane të shifrave statistikore, atëherë ai popull nuk është i lirë ta shpreh lirinë e të qenit pjesë integrale e këtij vendi. Kur dikush vazhdimisht të numëron dhe në fund shpreh dyshime për rezultatet përfundimtare, kjo krijon një ndjenjë jo të mirë psikologjike, por edhe një lloj disponimi kolektiv që relativizon sensin e faktorizimit. Për fat të mirë kjo nuk ka ndodhur me përmasa të mëdha tek shqiptarët e Maqedonisë, por është e evidente se për numrin e tyre flasin të tjerët, sidomos ata që janë të pasigurt në shifrat që mund të përmbysin realitetet demografike në Maqedoni.

Për ti mbyllur të gjitha dyshimet dhe hamendësimet, shteti duhet në një afat sa më të shpejt të hartojë edhe një strategji kombëtare për lëvizjet demografike, të cilat po ndodhin si pasojë e situatës politike e sociale në vend. Fundja, çfarë rëndësie ka organizimi perfekt i regjistrimit, nëse prej këtu do të largohet një numër i madh i popullatës. Kjo e fundit, do të duhej të jetë bregua e gjithë neve, e jo numri i shqiptarëve. Fundja, asnjë popull nuk avullohet dhe ata që shkojnë rrënjët sërish i kanë këtu, por është në mençurinë e shtetit të planifikojë politika zhvillimore edhe në bazë të potencialit njerëzor që ka.

PARA SE TË NDODHË "ILINDITASJA"

"Që të mos ndodhë të bëhen prapë gaz i botës, që mos të dalë ndonjë 'ilinditase' tjetër, dëshiroj të sugjeroj se cili duhet të jetë kriteri i përkthimit të emrit të ri të shtetit.

Tashmë është e evidente se emri i ri i shtetit do të jetë 'Republika Severna Makedonija', 'Republika Gorna Makedonija' ose 'Republika Nova Makedonija'. Cilido që të jetë, do të ketë, pra, një përcaktor i cili e cilëson fjalën emërore ose emrin 'Makedonija'. Pra, 'Gorna', 'Severna' dhe 'Nova' janë përcaktorë të emrit 'Makedonija'. Andaj, edhe në përkthimin që do të bëhet shqip duhet ta ruhet ky kriter dhe të mos i vihet përcaktori 'Republikës', por 'Maqedonisë'. Sepse, versionet 'Republika e Epërme', 'Republika Veriore' ose edhe 'Republika e Re' i referohen 'republikës', ndërsa në origjinal i referohen 'Maqedonisë'. Fundja, as bisedimet për problemin e emrit nuk janë bërë që të përcaktohet 'republika', por problemi ka qenë të përcaktohet 'Maqedonia'.

Në gjuhën shqipe përcaktori, qoftë si mbiemër ose si emër në gjinore, duhet të qëndrojë pas fjalës emërore, emrit bërthamë ose grupit emëror, pos në raste poetike. Por, meqë këtu kemi të bëjmë me stil administrativ, këto gjëra nuk lejohen. Prandaj, nëse u duhet ta përkthejnë, le ta kenë parasysh se në gjuhën shqipe përcaktori duhet të qëndrojë pas 'Maqedonisë'. Edhe nëse grekët e kanë kusht të marrëveshjes, që të mos jenë pranë njëri-tjetrit 'Republika' dhe 'Maqedonia', shqiptarët duhet të shpjegojnë se natyra e shqipes është e këtillë dhe nuk mund të bëhen improvizime. Edhe ashtu versioni shqip është i përkthyer dhe shërben vetëm për marrëdhënie brenda vendit, ndërsa origjinali dhe versioni anglisht do të mund ta kenë përcaktorin ndërmjet.

Pra, shqip do të ishte:

- Republika e Maqedonisë së Veriut
- Republika e Maqedonisë së Epërme ose
- Republika e Maqedonisë së Re...", shkruan në profilin e tij në FB, gjuhëtari dhe aktivisti i Lëvizjes BESA, Zeqirija Ibrahim.

DROGA NË SHKOLLA

"Rreth 20 për qind e nxënësve në shkollat e Kosovës përdorin substanca narkotike sipas OJQ 'Labyrinth' Kemi dyfishim të përdoruesve të narkotikëve nëpër shkolla nga viti në vit. Situata e kemi keq edhe në trafik, mbi 120 persona në vit vdesin dhe mbi 300 lëndohen rëndë nga aksidentet në trafik.

Nga ana tjetër, krimi dhe hajnia na ka mbuluar ama krejt të pafajshëm po shpallen!! Këtu edhe para kamerave live nëse kapesh duke vjedhur prapë se prapë do të shpallej i pafajshëm, bile bile futesh në politikë me CV të plotë", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Prishtina Mefail Bajqinovci.

MEDIACitate

REZOLUTË
NË DËM TË
LIBERALIZIMIT

Kuvendi i Kosovës të mërkurën ka miratuar një rezolutë përmes së cilës kërkohet që të hiqen kontrollet në pikat kufitare me Shqipërinë. Megjithatë, sipas njohësve të integritimit evropiane, kjo rezolutë është në kundërshtim me rekomandimin e Komisionit Evropian për kontrolle të dyfishta kufitare të dhënë në vitin 2015 në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

Në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave në korrik të vitit 2015 Komisioni Evropian (KE) pati rekomanduar që të bëhen kontrolle në të dyja anët në pikëkalimet kufitare me Shqipërinë. Por në kohën kur Kosova po i afrohet çdo ditë e më shumë vendimit për heqjen e vizave Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë e cila është në kundërshtim me rekomandimin e ekspertëve të Bashkimit Evropian të dhënë në vitin 2015.

Në rezolutën e miratuar të mërkurën kërkohet që ta bëhet hapja e plotë, pra të hiqen kontrollet në pika kufitare në Vërmicë, Qafë-Prush dhe Qafë-Morinë. Njohësit e integritimit evropiane thonë për "Zërin" se kjo rezolutë është në kundërshtim me rekomandimin e vitit 2015, ndërsa thonë se BE-ja do ta kundërshtojë heqjen e kontrolleve kufitare. Megjithatë sipas tyre, kjo rezolutë e sikurse edhe ajo për heqjen e romingut me Shqipërinë, që janë miratuar në të njëjtën ditë, do ta kenë fatin e rezolutave të mëhershme të Kuvendit, pra nuk do të zbatohen.

(Gazeta Zëri, 1 qershor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË "SINDROMA E STOKHOLMIT"?

Në gusht të vitit 1973, një tentativë e dështuar për të grabitur bankën "Kreditbanken" në Stokholm të Suedisë përfundoi në marrjen peng të katër nëpunësve nga grabitësit e armatosur. Pas gjashtë ditë traktativash të policisë suedeze me pengmarrësit, kriza u zgjidh kënaqshëm dhe pengjet u liruan të padëmtuar – po të përjashtojmë sjelljen e tyre të çuditshme në ditët, javët dhe muajt pas këtij incidenti.

Sepse viktimat e këtij akti të rëndomtë terrorist, ndërsa mbareshin të burgosur në një bodrum të bankës, u lidhën shpirtërisht me kriminelët që i mbanin peng, deri në atë pikë sa të tregonin mirëkuptim për arsyet e këtij akti e më pas, të përpiqeshin të siguronin ndihmë

financiare për të paguar mbrojtjen ligjore të ish-xhelatëve të tyre dhe të dilnin në gjyq për të dëshmuar në favor të kusarëve. Psikologët që e studiuhan këtë rravim në dukje absurd, e quajtën "sindroma e Stokholmit".

Menjëherë u vu re se kjo sindromë ndeshet rëndom në situata pengmarrjeje, por edhe në situata të tjera ku njëra palë mund të ushtronte lirisht dhunë ekstreme ndaj palës tjetër: në burgje e kampe përqendrimi, në marrëdhëniet midis shfrytëzuesve dhe prostitutave, ose edhe në familje ku burri keqtrajton gruan ose fëmijët. Sipas disa autorëve, mjaftojnë tre-katër ditë në këtë lloj situatë, që viktimat të fillojnë të ndiejë simpati ose mirëkuptim për xhelatin.

PARLAMENTI VOTON RIKONSTRUKTIMIN E QEVERISË

DEBAT PËR MINISTRAT E RINJ

Koha

Evis HALILI

Shkup, 1 qershor - Votimi i emrave të ministrave të rinj në Parlament ka ashpërsuar retorikën mes deputetëve të pozitës dhe opozitës. Ndërsa kryeministri Zoran Zaev rikonstruktimin e ka cilësuar si të nevojshëm për të siguruar shumicën parlamentare në miratimin e vendimeve të rëndësishme, por edhe të bazuar në arritjet profesionale të emrave të rinj, opozita e ka quajtur trukim, që synon zgjerimin e koalicionit qeverisës, për qëllime të tjera dhe jo rezultate më të mira. Me rotacionin e propozuar - në postin e ministres së Drejtësisë do të ulet Renata Deskoska (ish-ministre e Arsimit dhe Shkencës), ministër i Arsimit dhe Shkencës është propozuar Arbër Ademi, ministër i Kulturës, Asaf Ademi dhe ministër pa resor, Bardhyl Dauti. Duke theksuar se Maqedonia ndodhet përpara momenteve serioze, kryeministri Zaev ka sqaruar se përzgjedhja e anëtarëve të rinj të kabinetit qeveritar është ndikuar nga arritjet profesionale të tyre, personaliteti dhe kapacitetet e dëshmuara. Si shembuj ka sjellë ish ministren e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, si edhe vartësin e saj Arbër Ademi, biografia dhe arritjet e të cilin janë garanci se reformat në arsim do të vazhdojnë.

"Para nesh qëndrojnë aktivitete serioze reformuese dhe realizimi i një sërë vendimesh të mëdha të një rëndësie kruciale për vendin. Kemi kaluar nëpër një periudhë të konsolidimit dhe krijimit të kushteve për forcimin e shumicës parlamentare, në mënyrë që të krijojmë sa më shumë të jetë e mundur pranimin e vendimeve që do të na vijnë së shpejti, vendime të cilat do të përcaktojnë të ardhmen dhe historinë e shtetit



Kryeministri Zaev rikonstruktimin e ka cilësuar si të nevojshëm për të siguruar shumicën parlamentare në miratimin e vendimeve të rëndësishme, por edhe të bazuar në arritjet profesionale të emrave të rinj. Opozita e ka quajtur trukim, duke ngritur dyshime se synohet zgjerimi e koalicionit qeverisës për qëllime të tjera dhe jo rezultate më të mira pune

tonë", ka thënë kryeministri. Ai ka shtuar se sot flitet realisht për anëtarësimin në Nato dhe datë bisedimesh për anëtarësimin në BE dhe pavarësisht faktit se qytetarët mund të kenë shpresuar në një ditë më të mira menjëherë pas rënies së regjimit duhet ende kohë për zbatimin e reformave në të gjitha sferat. Opozita ka reaguar duke kundërshtuar rikonstruktimin si të paarsyetuar, por të bazuar në pazare politike dhe me qëllimin e përfshirjes së më shumë

partive shqiptare në qeveri. Si partnerë të rinj në koalicionin qeveritar do të hyjnë Besa, dega e Afrim Gashit dhe Partia Demokratike Shqiptare, të përfaqësuar me poste ministrore, si edhe Lidhja e Romëve. "Kjo që po ndodh sot nuk është

rikonstruktim në ato resorë ku nuk ka rezultate dhe me këtë rast do të përmend skandalet tel Puna dhe Politika Sociale, ekonomi dhe ministri të tjera. Ju, sot, personalisht po e merrni përsipër përgjegjësinë për skandalet dhe mosfunksioni-

min e ministrave", ka thënë Dimovski. Kryeministri ka sqaruar se në rast kur është deklaruar se ka dyshime për korrupsion e ka pasur fjalën për pushtetin ekzekutiv dhe jo për ministra apo zëvendësministra. Sipas tij është sinjal pozitiv që ka filluar dialogu për reformat dhe se hapat e parë janë bërë së bashku, si në reformat e nisura në gjyqësor, siguri dhe se duhet të vazhdojnë edhe në media, aty ku kanë ngecur, ka thënë kryeministri. Koordinator i VMRO-DPMNE, Dragan Danev, ka thënë se kjo qeveri do të mbahet mend për asgjë të realizuar edhe pas një viti.

"Kjo Qeveri do të mbahet mend si ajo që 'do të' qeverisë, pasi edhe pas një viti thotë 'do të'. Nuk ka bërë dhe s'ka arritur asgjë, s'ka rezultate edhe një vit pas formimit", ka thënë Danev.

Ndryshime të tjera në kabinetin qeveritar janë Andrej Zhernovski, si zëvendësministër i Punëve të Jashtme, zëvendësministër i Shëndetësisë Asim Musa, zëvendësministër i Punës dhe Politikës Sociale Cjonul Bajraktar dhe Sadik Beqiri si zëvendësministër i Transportit dhe Lidhjeve. Votimi i emrave të ministrave të ri ka ndodhur vonë pasdite.

GRUBI: OPOZITA TË MBËSHTESË REFORMAT DHE ZGJIDHJEN E EMRIT

Deputeti i BDI-së, Artan Grubi, i dha mbështetje Qeverisë dhe zgjedhjes së ministrave të rinj, por nga seanca e Parlamentit gjithashtu i bëri thirrje opozitës që ta japë mbështetjen e saj dhe të inkuadrohet në reformat dhe në zgjidhjen e kontestit me emrin. Pas zgjedhjes, sipas Grubit, kjo Qeveri është qasur me guxim dhe ka arritur ta kthejë besimin e qytetarëve tek institucionet, që është përfitimi i saj më i madh. "Kjo Qeveri e përfundoi krizën politike në Maqedoni. Lajmi në Raportin e KE-së nuk ishte rekomandimi pozitiv, por përfundimi i krizës politike", tha

deputeti i BDI-së. Për të sukses është edhe miratimi i Ligjit për gjuhët me ç'rast e ka rrumbullakësuar Marrëveshjen e Ohrit. "Shpresoj se këtij sukcesi do t'i bashkëngjitet edhe presidenti Gjorge Ivanov dhe do të vendosë nënshkrim në ligj", tha Grubi. Një pjesë e reformave janë arritur me opozitën, thotë ai, ndërsa pushteti dhe opozita duhej së bashku ta mbështesin edhe marrëveshjen me Bullgarinë, e cila tani është mbështetës më i madh i Maqedonisë, ndërsa ajo mund të jetë edhe Greqia. Grubi bëri thirrje për koalicion të të gjithë partive duke e përfshirë edhe VMRO-

DPMNE-së në mbështetje të reformave dhe zgjidhje të çështjeve më të vështira. "Ju ftoj të jeni pjesë e reformave dhe zgjidhjes së kontestit me emrin", tha nga foltorja deputeti i BDI-së, i cili dëshiron ta shohë Maqedoninë tërësisht të integruar në NATO dhe BE duke shfaqur shpresë se kjo do të jetë fytyra e re e VMRO-DPMNE-së dhe se do të përfundojë ndarjet e VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, të BDI-së dhe PDSH-së, të maqedonasve dhe shqiptarëve... Si opozitë detyrë e jona, tha deputeti i opozitës Zoran Ilioski nga VMRO-DPMNE, është që të vërejmë dhe kritikojmë.

QEVERIA VENDOS PËR NUMËRIMIN E QYTETARËVE DHE AMVISËRIVE

Regjistrimi i popullsisë në 2020-ën

Risi, krahas grumbullimit të kombinuar të të dhënave, në Regjistrim do të jetë edhe ajo që nuk do të përdoren formularë letre, por regjistrimi në terren do të zbatohet me shfrytëzimin e laptopit

Shkup 1 qershor - Regjistrimi i popullsisë në Republikën e Maqedonisë në vitin 2020 do të zbatohet nga data 1 deri më 21 prill. Në terren do të angazhohen rreth 5000 regjistruar, ndërsa këtë herë do të përdoret metoda e kombinuar që nënkupton përveç përdorimit të të dhënave në terren edhe të dhënave nga regjistrat. Vlerësohet se ky operacion do të kushtojë 8.5 milionë euro.

Këtë e thekson drejtori i Entit Shtetëror për Statistikë, Apostol Simonovski, në një intervistë për MIA-n i cili shpreh keqardhje që

ishte i pasuksesshëm regjistrimi në vitin 2011 dhe këtë si institucion do ta mbajnë si barrë.

"Pasi shënojmë 73 vjetorin e ekzistimit të Statistikës Shtetërore në RM me keqardhje të madhe mund të konstatojmë se pas asaj që ishim ndoshta më të njohur në vend - zbatimin e regjistrimit, në vitin 2011 ne nuk arritëm ta bëjmë. Pa marrë parasysh se cilat ishin arsyet dhe çfarëdo që ishin arsyet, këtë turp do ta bartim edhe një kohë të gjatë. Shpresoj se me zbatimin e regjistrimit të ri do të arrijmë të dëshmojmë se

megjithatë, se jemi institucion me kuadro për të bërë një studim të tillë statistikor dhe se më së paku te ne ka qenë arsyeja për moszbatimin e regjistrimit, edhe pse si institucion kemi meritë të madhe për atë që nuk është zbatuar. Këtë faj duhet ta pranojmë. Ky faj ishte për shkak se lejuam ose i hapëm dyert për të hyrë politika në regjistrim. Kjo është gjë që nuk mund ta lejojmë, të paktën derisa jam unë këtu dhe them se kjo nuk do të ndodhë. Ndoshta do të ketë tentime të llojllojshme, megjithatë do të përpiqemi një

gjë të tillë të mos e lejojmë, por të jetë ajo që duhet të jetë - operacion statistikor dhe asgjë më shumë", thotë në intervistë Simonovski. Risi, krahas grumbullimit të kombinuar të të dhënave, në Regjistrim do të jetë edhe ajo që nuk do të përdoren formularë letre, por regjistrimi në terren do të zbatohet me shfrytëzimin e laptopit. Ai thekson se me rëndësi është që në mënyrë të tillë për një kohë shumë të shkurtër do t'i fitojmë të dhënat përfundimtare, në vend se të pritët një vit e gjysmë apo dy. (D.K)

KRYETARI I PARLAMENTIT GREK PËR BISEDIMET E EMRIT

MARRËVESHJA NË PARLAMENT VETËM ME KUSHTET GREKE

Lidhur me bisedën telefonike midis kryeministrave të së dy vendeve, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, Vucis shfaq shpresë se "në 24-48 orët e ardhshme do të ketë përgjigje pozitive nga pala tjetër, që do të sjellë edhe dritë të gjelbër që të fillojë ndonjë epilog"

Athinë, 1 qershor - Vetëm nëse përmushen dhe përfundojnë të gjithë kushtet e parapara nga marrëveshja, atëherë do të ratifikohet nga parlamenti, tha kryetari i Parlamentit grek Nikos Vucis, ndërsa nuk e përjashtoi mundësinë, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes të mbahet edhe debati në Parlament. "Për shkak se bëhet fjalë për ratifikim të marrëveshjes që do të ketë edhe aspekte dhe garanci ndërkombëtare, sigurt që do të vijë në parlament, por në fazën përfundimtare, gjegjësisht sapo kushtet, sapo parakushtet që do të jenë të parapara, do të finalizohen", tha Vucis.

Lidhur me bisedën telefonike midis kryeministrave të së dy vendeve, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, Vucis, mbrëmë, shfaq shpresë se "në 24-48 orët e ardhshme do të ketë përgjigje pozitive nga pala



tjetër, që do të sjellë edhe dritë të gjelbër që të fillojë ndonjë epilog", njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Mendoj se sapo u realizua kjo bisedë telefonike, në të njëjtën kohë ajo të jetë edhe dritë e gjelbër që për shumë shpejt të fillojnë epilogjet që do ta caktojnë rrugën deri në zgjidhje të pranueshme të ndërsjellë, diçka që mendoj se do të jetë edhe në dobi të vendit tonë", tha kryetari i Parlamentit grek duke shprehur optimizëm se do të ekzistojë marrëveshje.

Lidhur me rastin me kishën,

gazetari nga ERT, duke iu referuar informatave të tij tha se është filuar procesi midis kishave që do të zgjasë rreth tre muaj, ndërsa pastaj do të kuptohet se nëse do të zgjidhet edhe kjo çështje, për çka Vucis iu përgjigj se të gjithë çështjet e hapura do të mbyllën së bashku dhe do të përfshihen në marrëveshje. Vucis tha se qëndrimi se "Maqedonia është një dhe greke", gjegjësisht mospranimi i një emri të përbërë, nuk është në dobi të interesit të Greqisë, ndërsa, madje i atyre të cilët kërkojnë referendum edhe në Greqi, iu përgjigj

se askush nga vendi nuk kërkon të japë diçka, që populli të mund të vendosë. "Vendit, nuk i është bërë thirrje të ndërrojë emër, me të drejtë zotëri Zaev dhe pushteti në IRJM thonë se do të mbahet referendum, për shkak se do të ndryshojë emri i tyre kushtetues. Në Greqi, nuk del ndonjë çështje e tillë. Askush nuk na kërkon të japim diçka, do ta kuptojmë këtë ndonjëherë? Askush nuk na kërkon të japim diçka, që të themi, është e mundur që të jepet ky ose ai emër, nevojitet që populli të vendosë", tha Vucis.

Mediat greke e presin telefonatën e Zaevit

Athinë, 1 qershor - Mediat greke në tekstet e djeshme për çështjen e emrit theksin e vendosin në bisedën e pritur telefonike mes dy kryeministrave, Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev. Biseda telefonike sipas gazetarëve të Greqisë duhet të ndodhte dje. "Aleksis Cipras pret thirrje telefonike nga homologu i tij, Zoran Zaev, ndërsa qarqet e Ministrisë së Punëve të Jashtme japin 90 për qind besueshmëri që kjo të ndodh sot. Burime qeveritare për real.gr thonë se "jemi në

fazën përfundimtare" dhe "presim të shohim nëse kryeministri i IRJM-së do ta tregojë përfundimin që të ketë përparim", shkruan portali Real. "Një bisedë telefonike e ndan Ciprasin dhe Zaevin nga marrëveshja e emrit. Thirrjen telefonike që me siguri do ta realizojë sot që të caktojë tet-a-tet takim në Prespë", shkruan edicioni online i gazetës "Ta nea". "Hapi i ardhshëm i prituri është biseda telefonike mes dy kryeministrave Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev që

mund të realizohet madje edhe në orët e ardhshme, shkruan "Kattimerini". Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, konferenca për shtyp e pardjeshme e kryeministrit të Maqedonisë, qëndrimet e djeshme të Zaevit nga foltorja kuvendore, pozita e presidentit Ivanov dhe protesta e nesërme e VMRO-DPMNE-së, janë pjesë e temave në mediat greke, në marrëdhëniet e Maqedonisë me Greqinë. Ngjarjet e fundit në relacionin Shkup-Athinë, gjatë

tërë kohës janë në fokusin e mediave të Greqisë, ndërsa gazetarët parashikojnë, duke u referuar në burimet e tyre se "Republika Veriore e Maqedonisë" është emri i cili është në përparësi në raport të propozimeve tjera të ndërmjetësuesit ("Republika e Re e Maqedonisë", "Republika e Epërme e Maqedonisë", "Republika e Vardarit të Maqedonisë" dhe "Republika e Maqedonisë (Shkupi)", propozim i refuzuar nga ana greke).

365 ditët e Kulturës

Shkup, 1 qershor - Ministria e Kulturës ka bërë një përmbledhje të 365 ditëve të punës gjatë periudhës një vjeçare të punës drejtuar nga ministri Robert Allagjovovski (qershor 2017-korrik 2018). Në kumtesën e këtij institucioni thuhet se janë ndërmarrë një numër i madh aktivitetesh për realizimin e programit të Qeverisë së re me të cilin mundësohet barazi, diversitet dhe mbështetje e fuqishme për artistët dhe punonjësit e kulturës, për projektet kulturore që ndërtojnë një shoqëri të përbashkët, decentralizimin e kulturës dhe aksesin e barabartë për të gjithë qytetarët. Nga gjithsej 365 masa pozitive më të rëndësishme, 15 për qind janë rezultat i punës së Ministrisë së Kulturës dhe bashkëpunimit me institucione të tjera. "Në fokus të aktiviteteve të Ministrisë ishin një sërë prioritetesh, para së gjithash çlirimi i institucioneve nga darat partiake dhe ideologjike të vendosura gjatë qeverisë së kaluar dhe hapja e institucioneve dhe kulturës për qytetarët, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, konsolidimi i punës financiare dhe likuidimi i borxheve, revizioni i punës, analiza dhe hartimi i një sërë vendimesh...", thuhet në kumtesën e këtij institucioni. (E.H)

Ivanovi sërish i kërkon Zaevit t'i dokumentacioni n për negociatat

Shkup, 1 qershor - Presidenti Gjorge Ivanov sërish kërkoi nga kryeministri Zoran Zaev t'ia dorëzojë propozimin për udhëheqjen e negociatave me bazë kushtetuese, projektin e marrëveshjes, si dhe qëndrimet e delegacioneve në udhëheqjen e negociatave. "Në mungesë të dokumenteve kyçe, ndërsa me qëllim të sigurimit të konsensusit më të gjerë për çështjen e emrit, presidenti i Republikës së Maqedonisë Gjorge Ivanov e inkurajon kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaev t'ia dorëzojë propozimin për udhëheqjen e negociatave me bazë kushtetuese, projektin e marrëveshjes, si dhe qëndrimet e delegacionit në udhëheqjen e negociatave", thuhet në kumtesën e kabinetit të presidentit. Ivanov mbetet në qëndrimin se nuk pranon zgjidhje për çështje të emrit për përdorim të përgjithshëm. Presidenti Ivanov, shtojnë nga kabineti, tregon në nevojën nga arritja e konsensusit kombëtar për tejkalimin e dallimit rreth emrit dhe gjetjes së zgjidhjes që nuk do ta prishë dinjitetin e popullit dhe qytetarëve të Maqedonisë.

SHBA-të mbështesin Zaevin dhe Ciprasin për emrin

Uashington, 1 qershor - SHBA-ja edhe më tej i mbështet negociatat aktuale nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara për problemin rreth emrit të Maqedonisë, kumtuari nga Departamenti i Shtetit për Zërin e Amerikës në gjuhën maqedonase, duke e theksuar mbështetjen për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar. "Shpresojmë se liderët e Maqedonisë dhe

Greqisë do të gjejnë zgjidhje të përbashkët të pranueshme për problemin me emrin, që do të jetë në interes të integritetit euroatlantik, prosperitetit ekonomik, paqes dhe stabilitetit në rajon", kumtoi Departamenti i Shtetit.

Kryeministri Zoran Zaev dje deklaroi se zgjidhja e kontestit shumëvjeçar për emrin asnjëherë nuk ka qenë më afër, por nuk dha

më shumë hollësi për marrëveshje eventuale, e cila sipas paralajmërimeve duhet të finalizohet në një bisedë telefonike me homologun e tij grek Aleksis Cipras. Presidenti Gjorge Ivanov, megjithatë, pas takimit të djeshëm me shefin e diplomacisë Nikolla Daimitrov në të cilën u informua për zhvillimin e procesit të zgjidhjes së kontestit me Greqinë, kumtoi se për të është

i papranueshëm emër për përdorim të përgjithshëm dhe ndryshimi i Kushtetutës. Ministri Dimitrov deklaroi se për çështjen e emrit duhet leadership dhe përgjegjësi e lartë nga të gjithë faktorët politik. "Nëse gjemë mënyrë ta mbyllim problemin me ruajtjen e identitetit dhe dinjitetit, të gjithë së bashku do të jemi në anën e drejtë historisë", tha Dimitrov.

SASHK PËR VENDIMET SELEKTIVE TË GJYKATAVE



MËSIMDHËNËSIT PRESIN TRANSFORMIMIN E VENDIT TË PUNËS

Janë mbi 1700 mësime të punës, sipas SASHK-ut, edhe pse plotësojnë kriteret ligjore, përsëri nuk kanë realizuar të drejtën e transformimit të vendit të punës me afat të pacaktuar. Komisionet përkatëse, sikurse tha avokati i angazhuar për zgjidhjen gjyqësore të problemit, kanë pranuar kërkesat. Mirëpo, pengesa thotë se ishte bërë për shkak të Ligjit të zgjedhjeve

statusin e tyre të vendit të punës. Edhe pse sipas Ligjit për marrëdhënie pune, do të duhej që të gjithë ata që janë të punësuar në arsim pas tre viteve angazhim të pandërprerë në një shkollë të caktuar të gëzojnë të drejtën e punësimit me afat të pacaktuar kohor, konkretisht me marrëdhënie të rregullt pune, prapëse prapë një numër i konsiderueshëm i tyre detyrohen të nënshkruajnë kontrata pune me afat të caktuar gjatë çdo fillimi të ri të vitit shkollor. Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës fajëson për këtë situatë gjykatat të cilat sipas kryetarit të SASHK-ut, Jakim Nedellkov, janë selektive në marrjen e vendimeve.

Nga viti 2009 e deri në mars të 2017-ës është realizuar transformimi i mbi 8 mijë vendeve të punës në institucionet arsimore. Mirëpo, janë edhe shumë të tjerë që edhe pse kanë nga pesë e më tepër vjet përvojë pune nëpër shkollë, nuk e kanë të rregulluar ende çështjen e transformimit të vendeve të punës. Kryesindikalisti Nedellkov thotë se ai numër

është rreth 1700 mësime të punës. Për të zgjidhur këtë problem, SASHK-u ka angazhuar zyrën e avokatit të Vanço Shehtanski, i cili ka ngritur mbi 120 padi për transferimin e vendeve të punës së mësimeve të shkollave filllore dhe të mesme nga marrëdhënie pune me afat të pacaktuar. Kjo u bë e ditur të premten në takim me gazetarë të SASHK-ut, ku edhe u prezantua Raporti lidhur me procese gjyqësore të hapura nga ana e Sindikatës pikërisht për kontestimin e (mos)transformimit të vendit të punës.

"Për të njëjtën lëndë, gjyqtarë të ndryshëm sjellin vendime të ndryshme. Gjykatat janë selektive në sjelljen e vendimeve", ka pohuar avokati Shehtanski, të cilin SASHK-u e ka angazhuar për zgjidhjen gjyqësore të kontestimeve me transformimin e vendeve të punës. Për këtë sjellje të gjykatave, ai ka shtuar se do të njoftojë edhe zyrën e Avokatit të Popullit, meqë janë shkelur nenet 6 dhe 7 të Ligjit për marrëdhënie

pune.

Shehtanski thotë se këto shkelje janë rezultat i ngatërresave ligjore që pasuan deri te Komisioni për punësim për shkak të Ligjit të zgjedhjeve të kaluara, të cilat pengonin transferimin e vendeve të punës. Komisioni në përbërje të një anëtarit të Sindikatës, Ministrisë të Arsimit dhe Komunave gjatë vitit të kaluar ka pranuar shumë kërkesa për transformimin e vendeve të punës të mësimeve me mbi dy vite punë në arsim. Epilogu i këtyre kërkesave është negativ ashtu sikurse edhe i shumë proceseve gjyqësore të hapura me iniciativë të Sindikatës.

Deri në vitin 2010, për transformimin e vendit të punës në arsim, mësime të punës duhej të pritnin pesë vjet nga dita e angazhimit të tyre. Duhej të kishin fond të plotë të orëve të mësimit dhe që shkolla të kishte nevojë për pranimin e dikujt në atë vend pune. Mirëpo, ai Ligj u ndryshua në fund të 2010-ës, kur edhe u shkurtua kohë e pritjes nga pesë në dy vjet.

Dënohet sulmi ndaj gazetarit të Alsat-M

Shkup, 1 qershor - Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Medial në mënyrë të ashpër e dënon sjelljen e dhunshme dhe primitive të anëtarit të Bordit Drejtues të Klasterit për tekstil Sashko Stanoevski ndaj gazetarit të Televizionit Alsat-M, Ilie Petreski në konferencën për shtyp në momentin kur ai ka parashtruar pyetje legjitime gazetareske. "Për fat të

keq, sërish patëm mundësi të dëshmojmë për trajtim të tillë me ekupe gazetareske të ekspozuara kur parashtrorjnë pyetje deri të ata të cilët veten e përjetojnë ose kanë trajnim të sundimtarëve", thuhet në reagimin e sindikatës. SPCM përkujton se konferencat për shtyp nuk janë poligon i keqtrajtimit dhe fyerjeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve medial, por vend

prej ku përfaqësuesit e Klasterit përmes komunikimit me ekipet gazetareske i drejtohen opinionit. "Prej atje, sjelljen që anëtarit i Bordit Drejtues të Klasterit për tekstil Sashko Stanoevski e demonstroi ndaj kolegut Petreski flet për sjelljen e tyre dhe respektimin e opinionit të cilit i drejtohen si dhe për paaftësinë e tyre të përgjigjen në pyetje legjitime të cilat pikë-

risht përmes gazetarëve opinioni do t'ua parashtronte", shtohet në reagim. SPCM kërkon nga Klasteri për tekstil në aktivitetet e tij dhe shërbimet citon edhe trajtime për anëtarët e tij të përkushtohet në edukimin e tyre për liri të shprehjes, interesin publik dhe përgjegjësinë e korporative, si dhe kërkim falje deri te kolegu Petreski i TV Alsat-M.

KRONIKË

Shkup, 7 të lënduar në 7 aksidente

Shtatë persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në shtatë aksidente të regjistruara në rajonin e SPB-së Shkup. Policia e komunikacioni ka sanksionuar 83 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa nga komunikacioni i ka përjashtuar 29 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit. Nga të sanksionuarit 13 shoferë kanë drejtuar automjetin ende pa e marrë patentë shoferin, pesë fillestarë dhe dy të tjerë. Nga komunikacioni janë përjashtuar 11 automjete të paregjistruara, 85 automobila të parkuara në mënyrë të paligjshme, ndërsa me automjetin special "karrotreci" janë mënjanuar 75 automjete.

Një 14-vjeçar përplaset nga një makinë

Një fëmijë katërmëdhjetëvjeçar ka marrë lëndime, pasi dje është përplasur nga një makinë në Shkup, kumtoi MPB-ja. Aksidenti ka ndodhur dje në orën 22 në rrugën "Indira Gandhi". Makina "Opel Zafira" me targa të Shkupit e drejtuar nga M. G (38) nga Shkupi është përplasur në një fëmijë-këmbësorë. Pas aksidentit me automjetin e Ndihmës së shpejtë mjekësore fëmija është transferuar në kompleksin e klinikave "Nënë Terezë", ku nga ana e mjekut i janë konstatuar lëndime dhe është mbajtur në Klinikën për Traumatologji për kurim të mëtejshëm. Nga ana e ekipit është kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes dhe punohet në ndriçimin e plotë të rastit.

Saraj, ia grabisin 6500 euro postierit

Një postier nga fshati Kopanicë sot është grabitur nga dy persona të maskuar para një restoranti në fshatin Gllumovë. Grabitësit me kërcënim me pistoletë i kanë marrë 400.000 denarë. Siç kumtoi MPB, grabitësit rreth orës 9 para restorantit me automjet udhltimi "Golf 4" me targa të panjohura dhe me kërcënim me pistoletë nga postieri E. I. (53) i kanë marrë paratë pas çfarë e kanë braktisur vendin e ngjarjes. Nga policia informojnë se po ndërmerren masa për gjetjen e kryerësve dhe ndriçimin e rastit.

(O.Xh)

BRENDIMI RRI EDHE SHITJEN

DIASPORA HAP DYERT E EKSPORTIT

Në Maqedoninë perëndimore nuk mungojnë prodhues të suksesshëm që shesin jashtë e të cilëve dyert e Evropës ua ka hapur diaspora. Megjithatë, kriza politike ka ndikuar që edhe kompanitë shqiptare në një pjesë të madhe të orientohen më shumë në stabilizim dhe jo në zgjerimin e biznesit drejt eksportit jashtë vendit

Koha Fisnik PASHOLLI



Shkup, 1 qershor - Në Maqedoninë Perëndimore nuk mungojnë prodhues të suksesshëm që shesin jashtë e të cilëve dyert e Evropës ua ka hapur diaspora. Megjithatë kriza politike ka ndikuar ngjashëm si te i gjithë biznesi në Maqedoni, që edhe kompanitë shqiptare në një pjesë të madhe të orientohen më shumë në stabilizim të biznesit dhe jo zgjerimin e biznesit të orientuara në eksport.

Nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore thonë se në të ardhmen, me stabilizimin gradual të gjendjes politike, mund të presim edhe realizimin e planeve të investimit të më shumë kompanive anëtare të OEMVP-së, të kemi rritje të brendimit, por edhe të eksportit të bizneseve shqiptare në Maqedoni. Njohësit e çështjeve ekonomike thonë se krijimi i një brendi në fusha të ndryshme paraqet një proces që kërkon kohë e që matet me një periudhë së paku pesëvjeçare, mjete financiare dhe resurse të tjera të çmuara që shpesh edhe ju mungojnë afaristëve shqiptarë.

Bile, shtojnë ata, edhe në nivel të Maqedonisë si shtet - në 25 vitet e kaluara kemi numër që nuk kënaq krijimin e brendeve të suksesshme, dhe të cilët kanë gjetur rrugën e tyre në tregun evropian.

OEMVP OFROHET TË NDIHMOJË

"Kompanitë ndërtimore nga Maqedonia Perëndimore kanë ndërtuar brende dhe shesin prodhimet e tyre jo vetëm në rajon, por edhe në shtetet perëndimore duke i falënderuar faktit se dallohet si me çmime ashtu edhe me cilësi. Megjithatë, nuk mund të jemi të kënaqur me interesimin për brendimin dhe mbrojtjen e markave tregtare. Apo ndoshta në këtë drejtim pengesë mund të jenë edhe procedurat e stërzgjatura për sigurimin e doku-

menteve që i paraprijnë procesit të mbrojtjes së markës tregtare. Gjithashtu, bizneset shqiptare janë relativisht të reja në treg, andaj së pari nevojitet të stabilizohen në tregun vendor të Maqedonisë e pastaj të mendojnë për të depërtuar në tregun e jashtëm", thotë drejtori i OEMVP-së, Drilon Iseni. Sipas tij, nuk duhet harruar se ndërtimi i brendit edhe në nivel të tërë Maqedonisë është një proces për të cilin nuk mund të dallohem si shtet për shkak se kërkon mjaft kohë, investime dhe punë të madhe.

Në ndërkohë, Iseni shprehet se në OEMVP-së ekziston një infrastrukturë e gatshme që mund tu ndihmojë bizneseve në brendimin e prodhimeve.

"Në kuadër të OEMVP-së vepron edhe Klubi i prodhuesve industrial, ku ideja është që të kemi një grupacion në një vend me sektorë specifik. Gjithashtu, ai është pjesë e Forumit prodhues mbarëkombëtar shqiptar. Në kuadër të Odës ekziston dhe ofron shërbimet edhe Qendra për pronësi industriale dhe mbrojtjen e markave tregtare që mund të shfrytëzohet nga ana e anëtarëve të Odës me çmime të leverdishme lidhur me brendimin dhe mbrojtjen e markës tregtare", thekson më tej ai. Iseni shton më tej se OEMVP angazhohet që kompanitë prodhuese të sjellin teknologji të reja, apo "knou hau" nga jashtë me qëllim që të krijojnë vlerë të shtuar të prodhimeve të tyre, por për këtë - megjithatë nevojitet që së pari të zënë vendin e tyre në tregun vendor dhe pastaj të mendojnë për tregjet e jashtme.

Gjithashtu, thotë Iseni, ato nevojitet të mendojnë edhe për të zëvendësuar importin me prodhimet vendore dhe pastaj të mendojnë për eksportin.

"Një vëmendje më e madhe në kushtet tona nevojitet ti kushtohet edhe inovacionit për bizneset shqiptare që siguron kosto minimale, efikasitet më të madh në punë, shfrytëzim maksimal të infrastrukturës, si dhe mundëson të jeni më të lirë në treg", shpjegon Iseni përfitimet e vendosjes së risive në afarizëm. Lidhur me ndihmesën e diasporës shqiptare për kompanitë prodhuese nga Maqedonia Veriperëndimore dhe me rritjen e plasmanit, promovimin, krijimin e kontakte të reja apo edhe marrëveshje të mundshme për eksport, nga OEMVP thonë se një ndihmë konkrete në këtë drejtim asnjëherë nuk ka munguar.

"Diaspora veçmë e ka luajtur rolin e saj duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me dhjetëra e dhjetëra kompani që eksportojnë nga Maqedonia Perëndimore jashtë shtetit e që posedojnë edhe cilësi të nevojshme për tregjet perëndimore. Me fjalë të tjera, ekzistojnë më shumë shembuj të eksportit të suksesshëm të cilëve dyert e Evropës ua ka hapur diaspora", thotë Iseni.

Nga OEMVP thonë se bizneset nga Maqedonia Perëndimore duhet të shqyrtojnë mundësitë dhe të investojnë në përpunimin dhe paketimin e prodhimeve blegtorale dhe bujqësore, prodhimtarinë e ushqimit organik, industrinë kreative, teknologjinë informatike...

BRENDIMI I MALLIT SHKON ME ZOR

Nga ana tjetër, njohësit e çështjeve ekonomike thonë se krijimi i një brendi në fusha të ndryshme paraqet një proces që kërkon kohë që matet me një periudhë së paku pesëvjeçare, para dhe resurse të tjera të çmuara.

"Krijimi i një brendi në fusha të ndryshme ekonomike paraqet një

proces që kërkon kohë, para dhe resurse të tjera të çmuara që shpesh edhe ju mungojnë afaristëve shqiptarë. Me fjalë të tjera për të krijuar një markë tregtare në prodhimtari nevojitet së paku një periudhë kohore prej së paku katër deri pesë vjet, investime që maten me miliona e miliona euro, kërkon angazhimin e inxhinierëve të profileve të ndryshme, teknologëve, specialistëve të marketingut, fuqisë punëtorë të kualifikuar dhe mbi të gjitha gjetjen e plasmanit në një treg me konkurrencë të madhe", thotë profesori universitar Neritan Turkeshi.

Sipas tij, krijimi i një brendi kërkon qarkullimin shumë të ngadalshëm të të hollave që kthehen vetëm pas disa viteve të investimeve, për dallim - për shembull, prej tregtisë ku kemi qarkullim të shpejtë të parave. "Bizneset me pronësi të shqiptarëve shpesh orientohen në veprimtari më të thjeshta ku mund të sigurojnë ekzistencën për familjen dhe punëtorët që i angazhojnë. Madje, viteve të fundit, përvojat e pjesës dërmuese të bizneseve në vend tregojnë se ato e kanë të imponuar mbijetesën dhe më pak e shikojnë zhvillimin e tyre në mënyrë afatshkurtër, ku shikojnë që të zvogëlojnë çdo harxhim të tepërt që e kanë për biznesin, e jo të investojnë në fusha të caktuara, siç është për shembull shitja jashtë shtetit dhe krijimi i brendeve", thotë Turkeshi.

Ndryshe, në vitet e kaluara, ekonomia vendore dallohej për nga frika nga investimi në ide të reja dhe niveli i ulët i vetëdijes për dobitë që sjellin inovacionet në zhvillimin dhe rritjen e bizneseve. Sipas ekonomistëve, niveli i ulët i vetëdijes i bizneseve që pak aplikojnë inovacione në punën e tyre ndërlidhet jo vetëm me mun-



NERITAN TURKESHI

Bizneset me pronësi të shqiptarëve shpesh orientohen në veprimtari më të thjeshta ku mund të sigurojnë ekzistencën për familjen dhe punëtorët që i angazhojnë. Madje, viteve të fundit, përvojat e pjesës dërmuese të bizneseve në vend tregojnë se ato e kanë të imponuar mbijetesën dhe më pak e shikojnë zhvillimin e tyre në mënyrë afatshkurtër, ku shikojnë që të zvogëlojnë çdo harxhim të tepërt që e kanë për biznesin, e jo të investojnë në fusha të caktuara, siç është për shembull shitja jashtë shtetit dhe krijimi i brendeve



DRILON ISENI

Diaspora veçmë e ka luajtur rolin e saj duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me dhjetëra e dhjetëra kompani që eksportojnë nga Maqedonia Perëndimore jashtë shtetit e që posedojnë edhe cilësi të nevojshme për tregjet perëndimore. Me fjalë të tjera, ekzistojnë më shumë shembuj të eksportit të suksesshëm të cilëve dyert e Evropës ua ka hapur diaspora

gesën e mjeteve financiare, por edhe me mungesën e kuadrit të specializuar në këto firma për zhvillimin e ideve, prodhimeve dhe shërbimeve të reja që bizneset hezitohen të punësojnë. Gjithashtu, ekonomistët duke shpjeguar dobitë që sjellin risitë në biznes, thonë se inovacionet nuk nënkuptojnë vetëm shpikje të mëdha dhe të shtrenjta, apo prodhime dhe shërbime të reja. Risi mund të jetë edhe përmirësimi i procesit prodhues, vendosja e sistemit të ri menaxhues e kështu me radhë. Vlerësohet se vendosja e inovacioneve ndikon edhe në rritjen e eksportit, fuqizimit të bizneseve vendore dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

SISTEMI I RI ELEKTRONIK PËR IMPORTIN E VETURAVE

HIQET NGA PËRDORIMI KATALOGU "SHVAGE"

Sistemi i ri elektronik që prej dje është në përdorim me vendosjen e numrit të shasisë, me çka do të përcaktohet vlera e saktë e doganimit të veturës. Ky sistem njëherësh do të mundëson transparencë gjatë përcaktimit të çmimit të automjeteve që doganohen, kështu që në këtë mënyrë do të marrim çmim real. Me mënyrën e re të përcaktimit elektronik nuk do të ketë më vlerësim jo real të automjeteve të vjetra

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 1 qershor - Nga 1 qershori i Drejtorisë së Doganave të Maqedonisë nuk do të llogaris vlerën e automjeteve të vjetra të importuara në bazë të katalogut "Shvage", por vlera do të përcaktohet në mënyrë elektronike. Këtë e bëri të ditur drejtori i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë Gjoko Tanasoski në takim të sotëm me gazetarët.

"Nga sot përcaktimi i vlerës së veturës së importuar nga jashtë nuk do llogaritet sipas zgjidhjes së tanishme në bazë të katalogut Shvage përmes të cilit përcaktohej çmimi minimal dhe ai maksimal. Kjo mënyrë e përcaktimit përmes katalogut "Shvage" i mbetet të kaluarës", deklaroi Tanasoski drejtori i Doganave. Sistemi i ri elektronik në të ardhmen do të përjashtojë të gjitha mundësitë e përcaktimit të vlerës joreale të automjetit të importuar. "Sistemi i ri elektronik që



prej sot është në përdorim me vendosjen e numrit të shasisë do të përcaktohet vlera e saktë e doganimit të veturës. Ky sistem njëherësh do të mundësojë transparencë gjatë përcaktimit të çmimit të automjeteve që doganohen, kështu që në këtë mënyrë do të marrim çmim real. Me mënyrën e re të përcaktimit elektronik nuk do të ketë më vlerësim joreal të automjeteve të vjetra", theksoi Tanasoski.

Sa i përket importit të veturave të vjetra në Maqedoni, Ta-

nasoski u shpreh se Doganat kanë përgatitur disa ligje, si Ligji për akciza si dhe ligji për vetura që nuk do t'i nënshtrohen akcizave.

"Ligjet e reja hartohen për shkak të nevojës të harmonizimit me legjislativin e BE-së dhe të gjitha ligjet që janë hartuar deri më sot në procedurë qeveritare të hyjnë më fuqi deri në fund të këtij viti", deklaroi Tanasoski.

Ai informoi se dogana në pesë muajt e parë ka realizuar pagesë të të ardhurave për 4,3 për

qind më shumë nga e planifikuarra për vitin 2018 dhe për 10,7 për qind më shumë se prej vitit 2017. "Më këtë po përmbushen prognozimet që i deklaruaam në fund të viti të kaluar si dhe në fillim të këtij viti se Dogana me rritjen e disiplinës dhe operatorëve ekonomik si dhe në përmirësimin e punë se administratorëve doganor dukshëm kanë ndikuar në të hyrat në Buxhet", deklaroi Gjoko Tanasoski drejtori i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë.

Qendër për autizëm në Gostivar

Shkup, 1 qershor - Udhëheqësia e re komunale në krye me kryetarin Arben Taravari, vëmendje të veçantë i kushton diskutimit dhe dizajnimin të prioriteteve zhvilluese dhe sjelljen e perspektivës më të madhe në mbrojtjen e personave me nevoja speciale, me theks të veçantë fëmijët, që edhe ata të bëhen pjesë e barabartë e shoqërisë së përgjithshme, që me të drejtë atyre u takon. Në këto gjashtë muajt të qeverisjes, siç theksohet në kumtesë, ndonëse me bllokada dhe obstrukcione të papara, punohet shumë në këtë drejtim, dhe tashmë janë krijuar kushtet për hapjen e një Qendre për fëmijët me autizëm në kuadër të godinës së Konviktit të nxënësve në Gostivar. Vlen të theksohet me këtë rast edhe kontributi i pamohueshëm i drejtorit të Konviktit të nxënësve, Shpend Sulejmani dhe donatorëve të ndryshëm, bashkëqytetarë tanë. Pritet që së shpejti, kjo qendër të vihet në funksion në bashkëpunim me partnerë, ekspertë të fushës.

Fluturim i parë i drejtpërdrejtë nga Varshava në Shkup

Shkup, 1 qershor - Në Aeroportin ndërkombëtar Shkup dje në mesditë është bërë fluturimi i parë i drejtpërdrejtë nga Varshava në Shkup, i aerokompanisë polake LOT Polish Airlines. Sipas organizuesit TAV Maqedoni, në pritjen e aeroplanit të LOT i pranishëm ka dhe fjalim ka mbajtur ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, drejtori i përgjithshëm i TAV Maqedoni, Alper Ersoj dhe drejtori komercial i LOT, Mihal Fijol. Fluturimet e kësaj linje do të realizohen gjashtë herë në javë, përveç të dielën. Çdo të hënë, të mërkurë dhe të premte janë paraparë fluturime nga aeroporti "Shopen" në Varshavë në orën 10:35, ndërsa arritja në Maqedoni në orën 12:20. Çdo të marte, të enjte dhe të shtunë fluturimi nga Varshava është caktuar për në orën 14:25, ndërsa ateron në Shkup në orën 16:30. Fluturimi nga Shkupi është planifikuar të jetë në orën 17:10, përderisa arritja në Varshavë është në orën 19:15.

Gati shpallja për ndarjen e tokës shtetërore për blegtorët

Shkup, 1 qershor - Është shpallur thirrja për parashtrimin e kërkesës për pagesën e 50 për qind të shpenzimeve për furnizim të bagëtisë, kumtoi ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave Lupço Nikollovski. Bëhet fjalë për masën nga programi për zhvillim rural për furnizimin e

bagëtisë nga importi apo me origjinë nga organizata të njohura për ato fermerë të cilët e kanë marrë bagëtinë deri më 31 dhjetor të vitit 2017. "Me qëllim të shfrytëzimit më efikas, Qeveria për shpalljet e ardhshme për këtë masë i ndryshoi kushtet. Fillimisht do të publikohet shpallja,

pastaj do të lidhet marrëveshja edhe pas realizimit të furnizimit do të kryhet pagesa. Në këtë mënyrë sigurohet siguri më e madhe për ata që do të kryejnë furnizim", deklaroi Nikollovski i cili me rastin e Ditës Botërore të Qumështit mori pjesë në ngjarjen në Qumështoren SHA Manastir.

KËSHILLI I AGJENCISË PËR MEDIA MIRATON NDRYSHIMET PRONËSORE

"Art Channel" edhe zyrtarisht bëhet "TV Klan"

Shkup, 1 qershor - Të premtën, Këshilli i Agjencisë për media dhe shërbime audio dhe audio vizuale mbajti mbledhjen e radhës me ç'rast vendosi pro ndryshimit të strukturës pronësore të Televizionit nacional "ART CHANNEL" nga Tetova në "TV KLAN" dhe pronar të ri Aleksandër Frangaj. Anëtari shqiptar në këtë Këshill, Milaim Fetaj

e përshëndeti një vendim të tillë, i cili sipas tij, do të pasurojë hapësirën mediale shqiptare në Maqedoni. "Pas verifikimit të dokumentacionit, konkretisht të biznes-planit, pamë se gjithçka është në rregull dhe nuk ka ndonjë pengesë për ndryshimin e strukturës pronësore. Pamë se do të jetë e njëjta strukturë e stafit aktual

dhe do të ndryshojë vetëm pronësia. Udhëheqësisë së re i dëshirojmë suksese në realizimin e misionit të tyre", tha Fetaj. Ndryshe, nga personi kompetent që raportoi për verifikimin e dokumentacionit, u tha se pronari i ri Aleksandër Frangaj i plotëson kushtet sipas legjislacionit të Maqedonisë të veprorë këtu dhe se në Regjistrin

Qendror nuk është i angazhuar në ndonjë biznes apo në ndonjë institucion tjetër në Maqedoni. Veç tjerash, anëtarët e Këshilli votuan edhe pro draftit të revizionit të Programit nacional për miratimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian (NPAA) 2019-2021, si dhe vendosjen pro dhënies së lejes për emetim të radios në nivel lokal,

në rajonin e Komunës së Strugës. Ndryshe kur jemi tek Këshilli i agjencisë në Parlament ende ka mospajtime rreth kushteve për zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe lënies të mbarimit të mandatit të anëtarëve aktual, siç po pretendon VMRO dhe zgjedhjes së anëtarëve të rinj, siç po kërkon LSDM. (F.R)



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIM TË PROPOZIM PROJEKTEVE PËR INSTRUMENTE

Mbështetje – grante të bashkëfinancuara për vendosje, punë dhe investime të akceleratorëve afariste-teknologjike (ose biznes akceleratorëve për të rinj) dhe Grante të bashkëfinancuara për ekstenzion teknologjik

ÇKA JANË BIZNES AKCELERATORËT PËR TË RINJ?

Biznes akceleratorët janë subjekte juridike që duhet të vendosin, sigurojnë metodologji të punës dhe investim në start-up ndërmarrjet e porsaformuara që do të bëheshin shfrytëzues të shërbimeve të akceleratorit.

CILI ËSHTË QËLLIMI I INSTRUMENTIT?

Qëllimi është të sigurohet mbështetje financiare për themelimin dhe funksionimin, implementimin të programit parainvestues dhe investime. Akceleratorët do të sigurojnë shërbime dhe mbështetje për start-up ndërmarrjet duke përfshirë hapësirë për zyrë dhe mbështetje administrative, trajnim, këshillim dhe/ose mentorim, qasje deri te resurset për zhvillim të biznesit dhe qasje deri te investimet financiare. Përmes Instrumentit për mbështetje të biznes akceleratorit sigurohen mjete financiare në tri faza:

- FAZA 1 – aplikuesi për biznes akcelerator duhet të ofrojë program parainvestues që përfshinë identifikim të shfrytëzuesve, definim të programit për trajnim dhe mentorim, mbështetje për zhvillim të biznesit, zhvillim të shërbimeve ose proceseve, marketing prototip.
- FAZA 2 – sigurim të mjeteve financiare për investime fillestare për shfrytëzuesit e zgjedhur të akceleratorit të cilët me sukses kanë kaluar Fazën 1.
- FAZA 3 – sigurim të mjeteve të mëtutjeshme financiare për investim për start-up kompanitë, shfrytëzues të akceleratorit, me potencial më të madh për rritje të shpejtë nga Faza 2.

KRITERE PËR PËRSHTATSHMËRI

Subjektet juridike të përshtatshme për financim përmes këtij instrumenti duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare ose Ligjin për shoqata dhe fondacione; të kenë shumicë të prodhimeve nga Maqedonia (50,1% ose më tepër), dhe të kenë strukturë pronësore të përbërë nga:

- Person/a fizik, dhe/ose
- Subjekt juridik si shoqëri tregtare, shoqatë ose fondacion,
- Njësi të vetëqeverisjes lokale – deri në 30% pjesëmarrje në strukturën pronësore të akceleratorit
- Institucion(e) për arsim sipëror ose shkencor(e) dhe hulumtues(e) – deri 30% pjesëmarrje në strukturën pronësore të akceleratorit
- Republika e Maqedonisë – deri në 30% pjesëmarrje në strukturën pronësore të akceleratorit

AKTIVITETE TË PËRSHTATSHME PËR FINANCIM

Menaxhim me biznes akcelerator; mbështetje administrative dhe teknike të punës së akceleratorit; mentorim, trajnim dhe këshillim të shfrytëzuesve të akceleratorit, si dhe përgatitje dhe realizim të evenimenteve; investime fillestare dhe investime të mëtutjeshme.

MJETE FINANCIARE

Deri në 75% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, në shumë deri në 500,000 euro për biznes akcelerator, ndërsa 80% e mjeteve të ndara për biznes akceleratorin dedikohen për investime në start-up kompanitë që do të bëhen shfrytëzues të tij.

KOHËZGJATJA E PROJEKTI

36 muaj kumulative

ÇKA PARAQET EKSTENSIONI TEKNOLOGJIK?

Ekstensioni teknologjik paraqet miratimin dhe harmonizimin e teknologjive inovative dhe të avancuara me qëllim të përmirësimit të proceseve afariste në mikro ndërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), përmirësim të produktivitetit dhe konkurrencës të tyre.

CILI ËSHTË QËLLIMI I INSTRUMENTIT?

Qëllimi i Instrumentit për ndarje të mbështetjes financiare për ekstenzion teknologjik është përmirësimi i konkurrencës së kompanive të vendit përmes bashkëfinancimit të investimeve në teknologji të reja.

Mbështetja financiare përmes këtij instrumenti mund të jetë e ndarë për dy faza të ekstenzionit teknologjik: diagnostika dhe Plani për përmirësim, dhe implementimi i planit për përmirësim. Në fazën e parë aplikuesi duhet të sigurojë diagnostikë në nivel të veprimtarisë ekonomike dhe plan për përmirësim të konkurrencës. Në fazën e dytë aplikuesi duhet të sigurojë implementim të planit për përmirësim përmes investimeve në pajisje dhe teknologji të reja.

KRITERET PËR PËRSHTATSHMËRI

Të gjitha kompanitë e regjistruara në Regjistrin qendror në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare; shoqata, fondacione, oda ekonomike, klasterë ose lloje tera të bashkësive ekonomike të themeluara në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Ligjin për oda ekonomike, me strukturë shumicë të pronësisë nga Maqedonia (50,1% ose më shumë).

AKTIVITETET E PËRSHTATSHME PËR FINANCIM

Faza 1 – shpenzime për menaxhim dhe administrim, deri 7% të buxhetit të përgjithshëm në këtë fazë; dhe shërbime konsultive për diagnostikë dhe përpilim të Planit për përmirësim

Faza 2 – implementim i Planit për përmirësim (menaxhim dhe administratë, deri në 7% të buxhetit të përgjithshëm në këtë fazë), furnizim të teknologjisë së re, licenca, certifikata për standardizim, adaptim të infrastrukturës, shërbime konsultive.

Në kuadër të një projekti janë përfshirë minimum 3 kompani të së njëjtës veprimtari ekonomike.

MJETET FINANCIARE

Deri në 50% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, në shumë prej 500,000 euro (grant) për projekt

KOHËZGJATJA E PROJEKTI

Deri në 24 muaj me atë që kohëzgjatja e implementimit nga Faza 1 nuk guxon të kalojë 6 muaj

BUXHETI I PËRGJITHSHËM I FTESËS PËR TË DYJA INSTRUMENTET ËSHTË 3,4 milion euro

AFATI PËR APLIKIM 27.07.2018 deri në ora 23:59

Më shumë detaje në lidhje me thirrjen publike për ndarje të mbështetjes financiare për formim të biznes akceleratorëve për të rinj dhe për rritje të konkurrencës së NVM përmes ekstenzionit teknologjik do të gjeni në: www.fitr.mk/akcelerator dhe www.fitr.mk/ekstenzija.

Dokumentet e kërkuara duhet të plotësohen në gjuhën maqedonase dhe në PDF format dërgohen në adresat elektronike në vijim: akcelerator@fitr.mk; ekstenzija@fitr.mk.



Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Institucioni publik Qendra ndërkomunale për punë sociale - Kavadar

Në bazë të nenit 110-e të Ligjit për Mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 70/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18) dhe Rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe paraqitjes për punësim, si dhe forma, përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së regjistrit të personave që kanë paraqitur të dhëna jo të vërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15) IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar publikon

SHALLJE PUBLIKE

Për punësim të katër (4) realizuesve për kohë të pacaktuar dhe një (1) realizues për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar

Të gjithë kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar:

- SOZ0303A06002 – Jurist i diplomuar** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, një (1) realizues, në Shërbimin për shërbime nga mbrojtja sociale.
Kushtet e posaçme
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Shkencat juridike) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
 - SOZ0303A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, një (1) realizues, në Shërbimin për shërbime nga mbrojtja sociale.
Kushtet e posaçme
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
 - SOZ0303A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, një (1) realizues, në Qendrën ditore për personat me pengesa trupore dhe mentale.
Kushtet e posaçme
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
 - SOZ0303A06009 – Logoped** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, një (1) realizues, në Qendrën ditore për personat me pengesa trupore dhe mentale.
Kushtet e posaçme
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Logopedi) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
- dhe një (1) realizues për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 për pozitën në vijim
- SOZ0303A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, një (1) realizues, në Shërbimin për të drejtë të ndihmës në të holla.
Kushtet e posaçme
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.
- Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter.
- Kandidatët duhet të parashtrorjnë dokumentet në vijim:
- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi – Diplomë për shkallën e arsimit të mbaruar;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Biografi të shkurtë;
- Letër motivimi.
- Orari i kohës së punës, orët e punës në javë: 40, orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës fillestare është **23.197** denarë.
Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar, gjegjësisht marrëveshje për kohë të caktuar deri më 31.12.2018.
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.
Fletëparaqitja për shpallje mund të merret nga arkivi i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar.
Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta parashtrorjnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta.
Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike pas përfundimit të të njëjtës do të informohen për kohën dhe vendin për kontrollimin e besueshmërisë së dëshmitë dhe realizimin e intervistës përmes formës me shkrim në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
Fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet ta parashtrorjnë në arkivin e Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar ose përmes postës në adresën në vijim: rr. "JNA" numër 11 Kavadar (me shenjë për shpallje publike)
Kontakt telefoni: 043/414-102, 043/141-456.
Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e parashtruara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kavadar



BURRI MASAKROI GRUAN ME THIKË

U masakrua me thikë nga bashkëshorti, teksa në shtëpi ndodhej edhe djali 17-vjeçar i çiftit. 52-vjeçarja Elsa Tereziu u masakrua me thikë pak ditë më parë në banesën e saj në Piacenza të Italisë.

Nga autopsia në trupin e së ndërës, rezultoi se gruaja ka tentuar të mbrohej dhe për këtë arsye kishte me dhjetëra të prera në duar e trup, si pasojë e goditjeve nga bashkëshorti i saj Xhevdet Mehmeti 57 vjeç. I dyshuari për krimin është në gjendje tepër të rënduar psikologjike dhe nuk mban mend mirë atë që ka ndodhur.

Ende nuk dihen qartësisht shkaqet që e çuan atë drejt krimit makabër, ngjarje e cila ndodhi në sy të djalit 17-vjeçar të çiftit.

“Është i tronditur dhe tani po e kupton atë që ka barë. Ai nuk mban mend shumë gjëra nga ajo ditë”, kanë thënë hetuesit.

Edhe dy djemtë 17 dhe 19-vjeçar të çiftit janë marrë në pyetje. Policia ka zbuluar

se Elsa Tereziu ishte dhunuar edhe më parë nga bashkëshorti por nuk e kishte denoncuar kurrë. Nga dëshmia që i është marrë 57-vjeçarit, policia po heton në pistën e xhelozisë. Mehmeti u ka thënë hetuesve se gruaja ishte xheloze pa shkak, dhe kështu ka nisur konflikti mes tyre që u mbyll me tragjedi. (noa.al)

Hajnat plagosin një kalimtare dhe vjedhin 10.000 eurove

Shkup, 1 qershor - Me plagë mbi gjurin e djathtë është plagosur një shkupjane 53 vjeçare në Shkup, pasi e ka qëlluar një plumb i shtënë nga disa grabitës, të cilët e kanë grabitur një banor të Kriva Pallankës, i cili ka qenë duke dalë nga ndërtesa në rr. "Rudi Çajavac" dhe i kanë marrë 10.000 euro. Policia informon se rreth orës 16:30 në rr. "Rudi Çajavac" në Shkup dy persona të panjohur me motoçikleta të markës së panjohur, prej të cilëve njëri i armatosur me pistoletë, është kryer grabitje ndaj M.S.(49) nga Kriva Pallanka, i cili në atë moment ka dalë nga ndërtesa, me ç'rast i kanë marrë 10.000 euro të cilat i ka pasur me vete. Gjatë braktisjes së vendit të ngjarjes njëri nga personat ka shtënë një plumb dhe e ka plagosur një kalimtare rasti P.O.D.(53) nga Shkupi. E plagosura me automjetin e Ndihmës së Shpejtë mjekësore është dërguar në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza" ku i është konstatuar plaga mbi gjurin e djathtë. Është kryer kontroll në vendin e ngjarjes dhe po ndërmerren masa për gjetjen e autorëve.

Nëna i pret organin gjenital djalit të mitur

Një çmenduri e vërtetë mund të quhet veprimi i një nëne, e cila i preu organin gjenital fëmijës së saj. Ngjarja vjen nga Kina e largët, ndërsa ndërhyrja në kohë e mjekëve bëri që i vogli të shpëtonte për mrekulli.

"Ai ishte në gjumë kur nëna pësoi një krizë nervore dhe mbante hanxhar në dorë", shkroi gazeta Guanzhou Daily.

Kur ajo kuptoi se çfarë kishte bërë, u përpoq të vriste veten. Ishin fqinjët ata që panë djalin të mbuluar në gjak, dhe e dërguan në spital shkruan noa. Babai i djalit ka nisur të kërkojë ndihmë financiare për faturat marramendëse



që duhet të paguajë për trajtim.

Nëna e foshnjës vuan nga çrregullime mendore dhe shpërthyes, që shkaktojnë zemërim të pakontrolluar.

Dasmorja gjendet e vdekur në oborrin e restorantit

Një 32 vjeçare është gjetur e pajetë në parkingun e një restoranti teksa ishte e ftuar në një dasmë familjare. Jozefina Çefaj është 32 vjeçarja e cila doli jashtë lokalit për të marrë ajër, por u gjet nga të afërmit në gjendje të rëndë shëndetësore. Edhe pse mori ndihmën e parë ajo nuk mundi të mbijetojë. Sipas familjarëve, ajo nuk vuante nga ndonjë sëmundje, ndërsa dyshohet për helmimi nga ushqimi. "Me date 31.05.2018 në orën 20.35 jemi njoftuar se në fshatin Melgushë, Shkoder jashtë një lokali, ka vdekur shtetasja Gj. Ç. 32



vjeçe banuese në "Ndoc Mazi" Shkoder. Nga informacionet paraprake të marra nga familjarët mësohet se pasi ka pas probleme shëndetësore ka dalë jashtë lokalit dhe në pritje të ambulancës ka ndërruar jetë, e cila është dërguar në Morgun e Spitalit Rajonal Shkodër. Po kryhen veprimet me grup hetimor dhe nga mjeku-ligjor për përcaktimin e shkakut të vdekjes", njoftoi policia e Shkodrës.

I preu keq flokët një klienti, berberi dënohet me 8 muaj burgim

Një berber i cili bëri një prerje flokësh një djaloshi duke i shkruar numrin 1, në kokë si një ndëshkim, bëri që të tjerët të qeshnin. Por ky veprim berberit i kushtoi me tetë muaj burg. Berberi Abdulrahim Omar, 21 vjeç nuk e mendoi se mund të ndëshkohej nga gjykata, kur i prishi flokët një 10 vjeçari, i cili sipas gjykatës u la me "dëm psikologjik dhe fizik", shkruan Metro.uk. Kur policia arrestoi Oma-

rin, ai i tha policisë se donte t'i mësonte djalin një mësim rreth rrezikut të prerjes së flokëve. "I riu ishte krenar për stilin e tij të flokëve dhe mendoi se ishte e rëndësishme për të. Ai pësoi dëm psikologjik dhe fizik", tha Prokurori Alex Radley. Omar, nga Bedford u deklarua fajtor për shkakimin e dëmit trupor më 18 shkurt, dhe u dënua dje nga gjykata e këtij vendi.

KRONIKË

E rrëmbejnë dhe e rrahin 27-vjeçaren

27-vjeçarja L.A. nga fshati Kopanicë e Tetovës, pasditen e së enjtes ka paraqitur se të njëjtën ditë rreth orës 11.00, deri sa ka qenë në një market në Tetovë, 21 vjeçari N.A. nga lagjeje Drenoc, bashkë me një person tjetër të panjohur, me forcë e kanë futur në veturë, me të cilën më pas janë drejtuar drejt rrugës "146", në Tetovë. Sipas policisë, më pas dy personat në një moment kanë ndalur veturën, prej nga e kanë nxjerrë jashtë saj, duke e shtrirë për tokë kanë filluar ta grushtojnë dhe shqelmojnë nëpër trupë dhe kokë, duke i shkaktuar lëndime të dukshme. Policia punon në zbardhjen e plotë të rastit.

Sërish aksidentohet një motoçiklist

Të enjten pas mesnate, në udhëkryqin mesë rrugëve "Ivo Ribar Lllolla" dhe "134" në Tetovë, ka ndodhur aksident trafiku, në të cilin kanë marrë pjesë vetura e tipit "Opel Astra" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 21 vjeçari A.K. nga Tetova, dhe skuter "Hanllong" të cilin e ka drejtuar 15 vjeçari nga lagjeja Drenoc. Në aksidentin lëndime trupore ka marur motoçiklisti, i cili me veturë tjetër është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, për dhënien e ndihmës mjekësore. Janë kryer hetimet, dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit, si dhe zbulimin e shkakut dhe rrethanave si dhe detajeve tjera lidhur me rastin.

Gjenden emigrantë të braktisur në Reçicë

Policia gjeti pesë pakistanezë dhe një indian në një automobil që pas arratisjes nga policia është lënë nga shoferi në hyrje të fshatit Reçicë. Në rrugën rajonale fshati Reçicë - fshati Vaksincë mbrëmë në orën 00:50 nëpunës policorë kanë dhënë shenjë ndalesë për automjetin e udhëtarëve "Opel Sindra", por automobili nuk është ndalur dhe është nisur drejt fshatit Reçicë. "Automjeti është gjetur i lënë në rrugë në hyrje të fshatit, ndërsa shoferi e ka braktisur vendin e ngjarjes. Në automjet janë gjetur pesë persona nga Pakistani dhe një person nga India, me ç'rast janë arrestuar dhe dorëzuar në SPB Kumanovë për procedurë të mëtejshme", informoi Ministria e Punëve të Brendshme në Buletinin ditor.

73-vjeçari largohet nga shtëpia

41 vjeçari M.P nga Reçica e Vogël, ka paraqitur se të mërkurën, nga shtëpia është larguar, babai i tij 73 vjeçarë me iniciale M.P. Sipas denoncimit, atë e kanë kërkuar në disa vende, si dhe janë paraqitur në celularin e tij, mirëpo nuk kanë asnjë informacion se ku gjendet. Janë marrë masa dhe aktivitete për gjetjen e 73 vjeçarit nga Reçica e Vogël. (U.H)

Guximi në politikë përtej PR-it!

Nga
Daut DAUTI



Sharl De goli shpesh merret si shembull për politikanin guximtar. Ai ishte një ikonë politike e ushtarake franceze, i cili kishte fituar shumë simpati gjatë rezistencës antifashiste, që sadopak kishte ruajtur krenarinë kombëtare të nëpërkëmbur nga Hitleri gjatë okupimit. Mirëpo, fill pas Luftës së Dytë Botërore, ai u gjet në sproven e rëndë me koloninë e vet, Algjerinë, e cila kërkonte pavarësi. De Goli mundte të vazhdojë me politikën "s'e japim dot Algjerinë!", por pa dashur të bëhet kalkulues se si do të reflektohet kjo në karrierën e tij politike, doli para popullit francez t'ia tregojë të vërtetën se Franca do të tërhiqet nga ky vend.

Duke marrë këtë shembull, dhe krahasojmë me këtë që po ndodhë në procesin e negociimit të emrit të ri të Maqedonisë dhe si sillet kryeministri i tashëm, Zoran Zaev, duhet të konstatojmë se ai është një antipod i Gruevskit, dhe shumë afër De Golit. Sepse, Zaevi me vetëdije të plotë u hyri problemeve të cilat nuk pati guxim ose nuk dëshoi t'i zgjidhë pararendësi. Ai nuk e ushqen publikun me identitetin antik të "zbuluar" në shekullin 21, nuk i provokon grekët, por me ta ulet dhe i shikon të gjitha mundësitë në një kohë kur ka trashëguar një disponim negativ prej më shumë se 60 për qind të qytetarëve që janë kundër çfarëdo ndryshimi të emrit! Kjo duhet të jetë vetëvrasje politike për Zaevin shikuar me logjikën e Gruevskit. Por, nëse krahasojmë se si u reflek-

tua një tjetër hap i guximshëm, ai i ligjit të gjuhëve në zgjedhjet lokale, do të shohim se gjithçka është relative, sepse pas humbjes me dallim të vogël kundrejt VMRO-së në zgjedhjet parlamentare, në zgjedhjet lokale e la Gruevskin me tri komuna rurale dhe një qytezë! Në këtë mënyrë votuesit maqedonas e kishin shpërblyer guximin për ta zgjidhur një problem të brendshëm, e jo kalkuluesin dhe manipuluesin me këtë lloj temash. A do t'ia falin qytetarët edhe kësaj radhe Zaevit kompromisin e paralajmëruar me Greqinë, e cila do t'ia hapte rrugën vendit drejt BE-së dhe NATO-s, që mund të shihet tashmë nga paralajmërimet për një dinamikë të përsheptuar? Ngjashëm mund të merret edhe veprimi i kryeministrit grek, Cipras, i cili, i shtyrë edhe nga presionet ndërkombëtare, i rreket ndryshe nga pararendësit e tjerë, ndonëse ka një disponim të indoktrinuar grek kundër emrit Maqedoni për fqinjin verior. Ndoshta në fazën tjetër, atë para referendumit, do të duhet të kyçet PR-i... Mirëpo, pa dashur të golorifikojmë këto veprime, është fakt se kemi të bëjmë me hapa dhe vendime të guximshme e vizionare, të cilat doemos e vënë në plan të parë interesin e shtetit, e jo atë të imazhit (PR-it), me çka mund të rrezikohet karriera politike. Duke flijuar madje me vetëdije rejtungun, realizon ato qëllime gjestratagjike të shtetit të deklaruar ka herë, por të rrezikuara nga kalkulimet politike të qeverisë së mëparshme.

Nëse kujtojmë ndonjë veprim

të guximshëm në taborin politik shqiptar, padyshim një episod i tillë është ai i vitit 2001, kur dy liderët e partive shqiptare, Imer Imeri dhe Arbër Xhaferi u rreshtuan me Ali Ahmetin në Marrëveshjen e Prizrenit, duke u bërë praktikisht zëdhënës të kërkesave të faktorit ushtarak dhe deri në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit, kishte një bashkordinim midis këtyre dy faktorëve. (As me presionet e Sollanës dhe Robertsonit nuk u tërhoqën nënshkrimet e tyre, por vetëm shpallën një lloj moratoriumi, sa për sy e faqe para publikut të shokuar të Maqedonisë)

Në fillim të pluralizmit ndër ne, politikanët nuk i dinin disa gjëra "të rëndësishme" të veprimit politik. Ata vepronin më shumë me emocione e teatralitet, e me më pak strategji politike të mirëfilltë për paraqitje para publikut të gjerë. Ose edhe nëse ka pasur diçka nga kjo e dytë, mund të ketë qenë fare spontane, pa përpunim "laboratorik". Me një fjalë, shumë vonë e kanë mësuar PR-in! Mund të ve bast se PR-in (Public relations) nuk e kanë pasur në dijeni as Gligorovi, as Cërvenkovski, e as Georgievski ose Buçkovski... derisa nuk erdhi Gruevski.

Pse është i rëndësishëm PR-i në "jetën" e një politikani ose subjekti politik? Pse sot mund të jetë më aktual se kurrë në Maqedoni? Strategjia e PR-it është një "metodë" e mirë për t'ia hapur rrugën një politike që të përkrahet nga publiku i gjerë, gjegjësisht, nga votuesit. E thjeshtësuar me gjuhën që kuptojnë masat, kjo


Zoran Zaev, është një antipod i Gruevskit, dhe shumë afër De Golit. Sepse, Zaevi me vetëdije të plotë u hyri problemeve të cilat nuk pati guxim ose nuk dëshoi t'i zgjidhë pararendësi. Ai nuk e ushqen publikun me identitetin antik të "zbuluar" në shekullin 21, nuk i provokon grekët, por me ta ulet dhe i shikon të gjitha mundësitë në një kohë kur ka trashëguar një disponim negativ prej më shumë se 60 për qind të qytetarëve që janë kundër çfarëdo ndryshimi të emrit! Kjo duhet të jetë vetëvrasje politike për Zaevin shikuar me logjikën e Gruevskit, ndonëse në rastin e ligjit të gjuhëve, asgjë nuk humbni nga rejtingu



strategji është kombinim veprime-sh e paraqitjesh publike që ta bëjë sa më joshës(e) një platformë politike, një figurë, një lider, apo një parti, shpesh duke ofruar atë "përmbajtje" ose "ofertë" që preferon votuesi, që "prekë në nerv". Shpesh krijon një iluzion të bukur, por, shpesh të rremë... Mangësia e kësaj strategjie shprehet më vonë, kur të jetë arritur qëllimi (të vihet në pushtet) dhe kur duhet të merren vendime të cilat e prishin "kulën e letrës" që e kanë ndërtuar. Dhe edhe më keq, kur subjektet e caktuara që e kanë ndërtuar imazhin e tyre përmes agjencive të PR-it, duhet të ballafaqohen me realitetin dhe kur duhet t'i hajnë fjalët e mëdha, ëndrrallat e shitura lirë...

Në këtë grackë e pat futur Nikolla Gruevski jo veten dhe partinë e vet, por e kishte bërë peng vetë shtetin. Nuk më mban kujtesa të jetë përmendur ndonjë agjenci PR-i në kohën e Branko Cërvenkovskit ose Georgievskit, por është përfolur mjaft një e tillë gjermane që me vite e ka ndërtuar imazhin politik të Gruevskit dhe VMRO-së, edhe atë: ndershmëri, drejtësi, angazhim 24 orësh (7 ditë në javë, jo korruptivitet. Në imazhin e ndërtuar vëmendje e veçantë iu kushtua MOS LESHIMIT PE grekëve ("mbrojtës i emrit") dhe shqiptarëve (ndonëse në disa raste, u desh të marrë vendime të rënda, si për heqjen e lëndëve të Hagës ndaj UÇK-së, me kërkesë të partnerit të koalicionit, ose flakaresha nga BDI-ja me bllokimin e ligjit për "brantellat", të cilin e pen-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 1 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

goi Talat Xhaferi me poezitë e Aco Shopovit dhe diskutimet e tij me heshtje, ose pengimi i kryqit të Todor Petrovit në Butel...!). Një element plotësues në ndërtimin e imazhit pozitiv, natyrisht, ishte përmes korrupsionit të mediave kryesore, tek të cilat derdeshin para buxhetore në emër të shumë aksioneve promovuese të Qeverisë, sepse, me mbylljen e televizionit më me ndikim (TV A1-shit), nuk kishte më medium me ndikim që do të kishte qasje kritike dhe ato të mbeturat pothuajse i korrupsionit në tërësi.

Pse është me rëndësi të ceket shembulli i Gruevskit në kontekst të kësaj teme, e cila nuk e ka PR-in, por guximin e politikanëve për të marrë vendime "të rënda"? Sepse, përmes PR-it, Gruevski dhe qeveria e tij, praktikisht arriti të ndërtojë atë imazh i cili pastaj e frenoi për të marrë vendime në interes të shtetit. Ato vendime do ta rënonnin imazhin: nëse do t'u lëshonte pe grekëve, nëse lëshonte pe para shqiptarëve (në këtë detyrë, rolin e "shpirtit të keq" do ta luajë "zonja e hekurt" e policisë, me imazh të ftohtë e të thartë, siç do të vërejë shumëkush, e cila do të promovojë dyshimin për armëmbajtje te femrat myslimane te rasti "Monstra"...). Po të vepronte ndryshe, do të ishte tradhti e idealeve që i promovoi, anise interesat kombëtare (shtetërore), me të cilat e kishin gojë plot, kërkonin vendime të guximshme për realizimin e qëllimeve gjeostrategjike të vendit, e jo ruajtjen e imazhit. Në këtë mënyrë, Gruevski do ta largojë Maqedoninë nga agjendat e deklaruara. Gruevski ndoshta do ta ketë shikuar dikur serialin anglez "Yes, prime minister", ku këshilltari i tij, gjithë kohën mban llogari për veprimet e kryeministrit, gjegjësisht, mban llogari se si do të reflektohet në rejtingun e tij çdo fjalë ose çdo veprim. Jo vetëm që nuk do të kacafytet me problemet, por do të ndërmarrë veprime të cilat jo që nuk i zgjidhin ato, por dhe do të vështirësojnë edhe më (si në rastin e "antikuzimit"), që i siguroi një pushtet të papenguar me shumë se dhjetë vjet! Me gjasë, është mishëruar për së tepërmi me "frytet" e PR-strategjive të cilat sot provohen anekënd botës dhe nuk do ta ketë marrë parasysh ndonjë shembull të politikanit vizionar e të guximshëm, si Charl de Goli.

Logjika e çdo veprimi politik është ardhja në pushtet, por ai nuk duhet të jetë qëllim në vete. Ballafaqimi me problemet dhe zgjidhja e tyre doemos duhet të jetë kryesorja, madje dhe me kusht që të flijohen pikërisht ato interesa partiake e karrieriste, të cilat disa subjekte i kanë në plan të parë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

REFORMAT?!



Një nga termat më të përdorur gjatë fushatës së fundit të Zgjedhjeve të Përgjithshme ishte: Reformat! Qeveria e re, e cila u pagëzua si Shefja e fateve tona, na u prezantua pikërisht si qeveria e Reformave.

Termi "Reformë" vjen nga latinishtja, ka lindur si nevojë e njerëzve për të shprehur konceptin e ridhënies formë një objekti apo një gjendje të caktuar. Më vonë kjo fjalë rriti pozitën e saj në qarqet politike duke u përdorur pothuajse ekskluzivisht nga politikanët. Kështu do t'i vinte radha që të monopolizohej dhe nga një e tillë dhe këtu tek ne, nga SDMS-ja.

Para se të merrte çelësat e kabinetit qeveritar, kjo parti pati një fjalë tjetër që e artikuloi shpesh: Përgjime! Një copë herë mbushën shtëpitë, rrugët, lokalet, çdo metër e kilometër të shtetit, me biseda që denonconin qeveritarët në pushtet për përfshirje në krime ekonomike, vepra të rënda penale, shkelje të ligjit me dy këmbë. Populli u ndje i revoltuar, kishte kohë që ndihej i fyer nga regjimi Gruevski-Ahmeti, por pas publikimit të përgjimeve audio të SDSM-së dukej se pika kulmore e durimit mbërriti. Tashmë rokada politike në zyrat e Qeverisë po bëhej gati dhe po, SDSM-ja me përgjimet në valixhet e saj elektorale filloi punën për të drejtuar vendin drejt një jete më të mirë!

Papritur ndodhën disa ndryshime në fjalorin e kësaj partie. Rralloi deri gati në eliminim total fjalën Përgjime dhe forcoi me të madhe fjalën Reforma. E meqë SDSM-ja me të ardhur në pushtet zbriti nga kali i përgjimeve dhe hypi në kalin e reformave, atëherë të shikojmë se si i ka shkuar

marrëdhënia me këtë proces.

Le t'i hedhim një vështrim këtyre Reformave të cilat tashmë kanë 1 vit që pretendohet të kenë filluar, le të shohim si ka qenë historia njëvjeçare e kësaj Qeverie?

Si fillim puna iu nisi keq. SDMS-së iu desh të fillonte një bashkëjetesë me një kosto të rëndë morale para elektoratit. Asaj iu desh të bashkë-qeveriste me partinë e BDI-së, parti të cilën e kishte denoncuar botërisht në kohën e shkurtër e tashmë me shumë pikëpyetje të përgjimeve. Ndoshta ky ishte dhe një shkak madhor që bëri SDSM-në të largonte nga përdorimi fjalën Përgjime, pasi në krah i rrinte dhe i rri një nga aktorët më të vjetër në skenën e politikës, një nga të ardhurit nga koha e dyshuar e Krimeve! BDI-ja dhe VMRO-ja ishin bashkë në pushtet si binjakët siamezë, Zaevi shpalli alarmin për bashkëpunime të mëdha me krimin të të dy partive në pushtet, por për ironi të fatit, për fatkeqësi të tij dhe ende më shumë të popullit, kryeministri aktual u desh të amnistonte për hir të pushtetit, një nga binjakët siamezë! Operacioni ishte i pamundur, binjakët siamezë kanë trup të përbashkët, ndaj në venat e Qeverisë rrjedh gjak i pushtetit gruevist përsa kohë Ahmeti është në qeveri.

Ndaj Reformat dolën një flluskë sapuni! Një shaka e hidhur politike, humor i zi! Populli ka filluar të ndihet Don Kishot dhe Sanço Panço, dy personazhe sa komikë po aq fatkeq!

BDI-ja, ka marrë tashmë rolin e zonjës së shtëpisë në pallatin qeveritar të Shkupit.

Kjo martesë me natyrë biza-re, aspak organike, tepër e dy-

Pas një viti qeverie kuptuam që fjala REFORMA duhet hequr nga fjalori. Ashtu si përgjimeve, edhe reformave kjo Qeveri nuk i shkoi dot për shtati! Ndoshta fjala e re që duhen të fusin është: mashtrim... fjalë e rëndë, por e ndershme në rastin e tyre!



shimtë dhe amorale sa të duash, ishte dhe fundit i Reformave të famshme të Qeverisë! Fundi Reformave që nuk filluan kurrë!

Pra asgjë e re nga qendra... Bomba që nuk plasën... vetëm disa petarda që kanë kërcitur aty-këtu, njësoj si petardët e fëmijëve për festën e Vitit të Ri...Të akuzuarit e BDI-së u shpallën të pafajshëm pa gjyq, u harruan...për hir të kujt?! Populli sërish u kthye në një qenie naive, që i thuhet të vërteta të ndryshme nga i njëjti burim, si puna e Zaevit që brenda pak muaj nga gishti që e drejtoi nga Ahmeti, kaloi çuditërisht në mikun e tij që i hedh krahun! Është kjo politikë legjitime?! Apo është hipokrizi amorale ndaj popullit?!

Duke respektuar prezumimin e pafajësisë, të paktën të dinim që ishin të pafajshëm! Personazhe politik të ngjashëm me personazhe të trilluar, që notojnë më ujëra eurosh e makinash lukzose, punësime dhe pushime nga puna me karakter krejtësisht politik, regres ekonomik, ikje masive, dë-

shpërim popullor, komedi situatash me Çështjen e Emrit të shtetit e ndonjë "mrekulli" tjetër si këto, janë konkluzionet e këtij viti të mbrapshtë për ne!

Nuk është viti i parë që shkon nga e prapta për ne, por është më i trishtuar sepse nga viti i shpresës, rezultoi në vitin e zhgënjimit!

Pra qeveria Ahmeti-Zaev të vetmen gjë që ka reformuar është: emri dhe mbiemri i një pjesë të qeveritarëve, pasi sistemi mbetet po i njëjtë ...gruevist ...ahmetist ...zaevist! Pas 1 viti përpjekje për reforma, qeveria ngeli në klasë!

Komunave që humbi BDI-ja në Zgjedhjet e fundit Lokale, iu është vënë litari në fytyrë! Të anatemuara vetëm pse nuk kanë votuar BDI-në, qytete të tëra janë shpallur armike! Ata janë jashtë konsideratës së qeverisë, madje të ndëshkuar prej saj! Me politikë të vjetër, njerëz të vjetër që ende mbetën në qeveri, zhytën edhe porsaardhurit në lllumin e vjetër! E bën qeverinë e re armike të popullit i cili do të ndëshkojë me votë dhe do ndëshkojë ashpër tradhtinë e radhës!

Është një dështim i frikshëm! Ndoshta SDSM-ja nuk e dinte që i mbyturit të mbyti...BDI-ja, binjakja siameze e tërhoqi me vete... Asgjë nuk ndryshoi! Madje më keq, gjithçka po shkon drejt një varfërie më të madhe, drejt një tkurrje më të madhe të popullsisë!

Pra pas një viti qeverie kuptuam që fjala REFORMA duhet hequr nga fjalori. Ashtu si përgjimeve, edhe reformave kjo Qeveri nuk i shkoi dot për shtati! Ndoshta fjala e re që duhen të fusin është: mashtrim... fjalë e rëndë, por e ndershme në rastin e tyre!


(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Mjerim i madh, fatkeqësi e madhe
5. Lezet
7. Mal mes Shqipërisë dhe Maqedonisë
9. Radhit faqet e librit për shtyp
10. Diferencë
12. Dhoma e posaçme, me gra, e pashallarëve
13. Kusar
14. Pjesëtar i popullsisë së Greqisë së lashtë
16. Lëvizje politike palestineze
18. Shkronjë greke
20. Banor i rajonit rreth Tisës së lashtë
23. Këtë ditë
24. Gjahtar i Amerikës Veriore
26. Pjesa përmbyllëse e një veprë letrare
28. Banor i Çekisë
- 29. Emri i këngëtares sonë në foto**
30. Shoshit
31. Qytet në Shqipëri
33. Ata që determinojnë, përcaktuesit
41. Rroba mbështjellëse për fëmijë
42. Qytet në Kosovë
43. Elefant
44. Lukunia, zogoria
47. Prapa
48. Përballim vështirësish, duresë
49. Legurë e iridiumit (shq.).



VERTIKALISHT

1. Veshje për këmbën
2. Sipërfaqe ujore
3. Shifër
4. Pjesë e përparme e kokës
5. Monedhë, para
6. Jevgjit
8. Fëmijë mashkull, çun
9. Ia heq dënimin dikujt
11. Shaka
12. Llogari
14. Tantali
15. Qytet në Gjermani
17. Gur i çmuar, perla
18. Tufë e madhe bagëtish
19. Mënyrë shkrimi apo sjelljeje
- 21. Mbiemri i këngëtares në foto**
22. Shkrin në ujë
23. Seleni
24. Send adhurues te fiset primitive
25. Shko
27. Qytet në Shqipëri
30. Ndjekja e mësimëve në universitet
32. Parafjalë gjermane
33. Dajre
34. Shkronja e parë arabe
35. Fill metali
36. Aktorja amerikane, Margaret
37. Erbiumi
38. Ish portieri gjerman, Majer
39. Kryeneçësi
40. Pjatë e thellë
45. Shkëmbi
46. Vepër e Josip Relës.

Kakuro

e lehtë

				17	34	
			17			
		34	4			
	26					
	17					4
18				9		
				17		
15			19			
		17				
	28					
	12					

mesatare

	3	7				
3				29	30	
21						
	18					
					7	
			14			
			28			17
						9

e vështirë

	6	16		18	10	
10				8		
				35		
30						
			14			
			11			
		15			12	9
		29				
	15					
					4	


KOHA e lirë
për më të rinjtë

FSHEHËSIRA

Zbuloni figurat e fshehura!



Labirinti



FIGERMA (lexoni me objekte)

Pemët

Figurat gjeometrike përfaqësojnë shkronja. Zëvendësoni ato dhe do të gjeni pesë lloje pemësh!

Figurat paraqesin shkronja, varësisht nga forma e tyre. P.sh. te rrathët do t'i shënoni zanoret.

○ a, e, o, u, y

◌ ë, i

□ c, ç, m, n, r, s, v, x, z

▭ rr

▭ b, d, f, h, k, l, t

▭ dh, ll, sh, th, xh, zh

▭ gj, nj

▭ g, j, p, q

1 □ ○ □ □ ○

2 □ ○ □ □ □ ○

3 □ ○ □ □ ○

4 □ □ □ □ ○ ○

5 □ □ □ □ ○

Ndihmë: Janë përdorur 15 shkronja të ndryshme, prej të cilëve 5 zanore.

10 dallimet

Cilët janë ato?



Mini KENKEN

Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

1 -		3 x
3 x	7 +	

Sudoku

i lehtë

	1	9		3		7	4	
				2				
7			1					8
8	2		6				3	
		6				4		
	7			3		8	9	
1				4				3
			1					
	8	7		5		9	6	

mesatar

3	2			1		5	8	
5				6				2
	7	1		2		3	4	
	3						9	
			2	9				
9		5			2		7	
	6	7		4		9	2	
2				8				5
4	5			2		8	6	

i vështirë

	3	2			5	9		
6				5				4
5								1
9	2			3	6			
			2	1				
		8	6				2	9
1								7
8			3					2
	4	5			1	6		

Shkronjat e pjesës së hijezuar të fjalëkryqit bartni në tabelë. Me ato shkronja do t'i fitoni zgjidhjet e **rebuseve**, të cilët kanë të bëjnë me krenarinë e futbollit tonë.

1	2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15	

SKANDI I KOMBINUAR



Rebusi anagramor



Çelësi: 4, 4
Rebusi

MENSUR MAMUTI	MODEL SHEMBULL (HUAJ)	ARBËN XHAFERI	ORTEK DEBORE	ALUMINI	SËMUNDJE E RENDË NGJITËSE, ZGJEBE	PROGRAMI I VEPRIMITË NË NJE PARTIE ENERJIA	P	VETURË GJERMANE	GRAMI	RADIUMI	THIRRJE TELEFONIKE	BAÑORI, EMIREDITËS
LLOJ KATERKËNDESHI												
NGUTJE, NËXTIM												
RUMANIA												
NËSIA PËR MATJEN E FUQISE SË RRYMËS ELEKTRIKE							1					
ISH FUTBOLLISTI ITALIAN, SHIREA					2	3	4					
ORGANIZATA LIBERTAS				4		5	6	2	7			
SPORT NË LUJË			8		5	9	10	8	11	10		
KOHA E LIRË			9	10	11	12	2		4	13		
SPANJA				2	4	14		2	3			
USHTRIM, STERVITJË					3	11	10					
NËJERR TINGULLI TË PËRVAJSHËM						10	15					
VË DIÇKANË VENDIN E VET												
V												
MOLDOVA												
MJET SINJALI, SIRENE												
FILZOZOF I VJETËR GREK												

1 VËSHITJE

SUDOKU

NONOGRAMI

MOSBARAZIMI

ARUKONE

KENKEN

SUDOKU "2"

NUMERKRYOJ

Fjala e errët: DITË, KA, SY, NAVE, KA, VËSHJE

SKANDI I KOMBINUAR

KRIPPROGRAMI

FSHEHËSIRA

Zbuloni figurat e fshesura!

DALLIMET

LABIRINTI

MINI KENKEN

KAKURO

FALËNDRIM I RASIS

PËRPLASJA E ASHPËR E HARADINAJT ME KURTIN

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj dhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti janë përplasur në seancën e Kuvendit të Kosovës, ku deputetët po mbajnë interpelancë me kryeministrin lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in, për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës, raporton Periskopi

Ishte deputeti i VV'së, Albin Kurti, i cili në fjalimin e tij sërish sulmoi kryeministrin Haradinaj, premtimet e të cilit tha se nuk do të realizohen asnjëherë pasi ai aktualisht është në pozitë të dobët.

"Ai ka Qeveri të pakicës me vetëm 52 deputetë, ku kryeministri nuk i ka as çerekun e tyre. Një kryeministër në pozitë kaq të dobët s'mundet me bashku Mitrovicën e as me i mbajt premtimet për atë pjesë të territorit. Kritika ime është që për të mbetur Haradinaj kryeministër, duhet të vazhdojë të jetë ushtrues detyre i presidentit aktual, Thaçit", tha Kurti.

Tutje ai foli edhe për bisedimet



Kosovë Serbi në Bruksel, ku tha se fillimisht duhet të silltet në Kuvend një platformë që tregon se çka ka ndodhur me këtë dialog nga viti 2011 deri në vitin 2018.

"Na nevojitet një bilanc për dialogun 2011 e 2018, e jo me na ardh platformë ku shkruan se Thaçi na prin në këto bisedime", tha tutje Kurti.

Atij i reagoi menjëherë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

"I nderuar Albin, jo që nuk e mbajta mend prej fillimit, por po ua nisi nga fundi, se ti i ki ma për qefi këto politike se këto ekonomike s'pot shkojnë hiç. S'janë për ty ato, se pom dokesh si vetja që ulna me eksperta e s'po marr vesh sen. Për parti, unë i kam veç 10 deputetë, të huajt e të konopit, ama asniherë s'kanë livrit. Qata janë. Edhe nëntë në kofshin. Jom shku në burg e kam nejt tetë vjet, e kur jam kthy qitu i kam gjetë. Maj

edhe ti tut në mujsh. Se e kupton për çfarë po flasim. Unë kam kandidu me një koalicion. E kam përbi marrën, e kam jep dorën. Na s'jena përfekt. Edhe ju një parti jeni kanë e jeni nda", tha Haradinaj në kundërpërgjigjen e tij për Kurtin.

Sërish reagoi Albin Kurti.

"Së pari kryeministri u desht të përmend një dallim thelbësor të deputetëve tanë, se deputetët e VV'së nuk janë familjarë e kushëri të mijë. Nuk është që janë të huajt e të konopit, por janë të shtëpisë. Edhe me u nda, prapë mbesim më shumë se AAK'ja. Për dialog ju keni marrë stafetën nga presidenti dhe po vazhdoni në rrethin e njëjtë. S'ka kurrfarë kuptimi. Ky u kanë i detyruar me sjell Demarkacionin e me miratu, për me qenë kryeministër. Haradinaj s'është kryeministër. Është veç në detyrë. Është shndërruar në korrier të presidentit", tha Kurti tutje.

Haradinaj sërish u

kundërpërgjigj.

"Janë disa punë që i ka bërë Qeveria, që tregojnë se kjo Qeveri ekziston me të vërtetë. Ty s'ta ka ni për Demarkacion hiç, e keni pas veç kartë. As kolegëve tu që i ki afër nuk ua ka ndi. Nuk ju dhimti hiç minimizimi i raportit të Bulliqit. Mbesim me përgjegjësitë që ne i kemi marrë. Jemi me Veselin. Edhe ty ta pata dhanë dorën, po s'mujtëm me çu ma larg", tha kryeministri.

E Kurti kundër-replikën e tij e nisi me raportin për Demarkacion.

"Ne kemi qenë bashkë në kundërshtimin e Demarkacionit. Na s'e kemi ndërru rrugën. E keni keqpërdor opozitarzmin për me u shit më shtrenjtë tek ata. Po të mos ishte Haradinaj në opozitë me neve nuk do t'i rritej vlera aq shumë, sa ta marrin Thaçi e Veseli. Nuk e kisha besu që sërish e sillni në Kuvend raportin e Murat Mehës, pas raportit të Bulliqit. Ne nuk do ta bënim një gjë të tillë. Janë ndryshuar vetëm fytyrat e kryeministrave e ministrave, asgjë më shumë", tha Kurti tutje.

Haradinaj nuk u ndal.

Sërish i reagoi Kurtit.

"Sikur të kish qenë Shpend Ahmeti, kryetar i partisë simotër tash në Vetëvendosje, ndoshta tash kishi thënë se një punë e ke bë sa ke qenë kryeministër, e ai është Ligji për Prishtinën. Por, meqë nuk e kinë parti, tash as atë punë nuk po ma ngjeh. Po nasht", tha shkurt i pari i Qeverisë.

Kurti edhe njëherë iu kundërpërgjigj kryeministrit, të cilit i tha se zgjidhja e vetme është që të devijoni nga temat.

"Ishte me neve, shkove të Thaçi e Veseli, e tash mendon që t'u i devijon temat, harrohen ato që u thanë më herët. Ty të kanë marrë me qira për me kry Demarkacionin e Asociacionin", tha Kurti.

Haradinaj në reagimin e radhës sërish ia përmendi Kurtit Ligjin për Prishtinën e Statutin e Trepçës.

E Kurti tha se secili vendim politik ka pasoja socioekonomike, por kjo nuk do të thotë se ju keni vizion socioekonomik.

"Unë s'po e shajë askënd, veç po e përsëris se Qeveria me 52 deputetë është sharje e ofendim për Republikën parlamentare", tha Kurti.

Tutje, Kurti tentoi ta testoi kryeministrin.

"Sa metoda janë për ta llogaritur bruto produktin vendor dhe na thoni njëherë nga to", deklaroi Kurti.

"Më doket në të njëjtën klasë në ekonomi jena unë e ti, se jena t'u i mshu në të njëjtën kohë me investime kapitale. Faleminderit për metoda. Investime publike e private, qato po i mësojnë ton. E kemi Lumirin, Dardanin e të tjerët që na ndihmojnë. Duhemi me qenë më korrekt", u përgjigj Haradinaj.

Për herë të fundit, fjalën e mori Albin Kurti.

"Unë e bëra një pyetje për raportin e kryeministrit me dijen. S'ka nevojë me na tregu sa metoda, po t'na kallxon metodën më të lehtë me llogarit bruto produktin vendor. S'mundesh me qenë kryeministër, e mos me dit qysh llogarit bruto produkti vendor", tha Kurti. (Periskopi)

Vuçiq : Çështja e Kosovës më e vështira



Presidenti serb Aleksandar Vuçiq tha sot se është shumë i shqetësuar për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe sesipas tij, shqiptarët frikësohen se me mbështetjen e heshtur apo substanciale të dikujt ata jo vetëm që do të sjellin trazira dhe frikë ndaj serbëve, por do të marrin edhe masa të tjera.

Ai theksoi se trazirat ishin një shkas për dhënien e pavarësisë së Kosovës dhe shtoi se shqiptarët nuk bëjnë asgjë vetëm.

Çështja e Kosovës është më e vështira, me paqe të mundshme

për Ballkanin

Kreu i shtetit serb i tha gazetës "Le Monde" se për çështjen e Kosovës dhe raportet me Prishtinën po i pret gjëja më e vështirë, por nëse arrihet paqja atëherë gjithçka bëhet e mundur për Ballkanin.

"Bëhet fjalë për fatin e qindra mijëra njerëzve, për konfliktin shekullor territorial. Kjo është vendimtare, nëse kjo çështje nuk zgjidhet, Serbia nuk do të ketë të ardhme", tha ai në intervistën e titulluar "Kosova: Presidenti serb gati të flasë për gjithçka".

Policia e Shtetit: Nuk po survejojmë familjen e Lulzim Bashës

Policia e Shtetit përgenjshtron se është duke survejuar familjen e kreut të PD-së Lulzim Basha, duke e quajtur spekulim mediatic.

"Përgenjshtrim rreth lajmit se familja Basha mbahet nën survejim – përmbajtja e shkrimit, një spekulim mediatic për qëllime të mbrapshta

Nuk është aspak e vërtetë që familja e z.Lulzim Basha, kryetar i PD-së, apo familjarë të tij, të mbahen nën vëzhgim nga forca policore.

Përmbajtja e shkrimit është tërësisht një spekulim mediatic me synim mashtrimin dhe keqinformimin e opinionit publik për qëllime që i gjykojmë të mbrapshta. Me keqardhje konstatojmë se lajmi në fjalë duket i fabrikuar nga zyrat e një partie politike dhe jo nga redaksi serioze, raporton TCh, transmeton Klan Kosova.

Informimi i publikut rreth ve-



primarisë së institucioneve të shtetit është një e drejtë e garantuar me ligj, prandaj nëse dikush do të kishte interes rreth së vërtetës, do ta merrte informacionin lehtësisht në rrugë zyrtare.

Me këtë rast theksojmë se z.Basha përfiton nga statusi si kryetar i opozitës, masa shtesë dhe shoqërohet nga forca të Gardës së Republikës.

Por nuk ka në asnjë moment dhe në asnjë rrethanë, monitorim survejues të tij nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Duke vlerësuar rolin e medias, Policia e Shtetit është e gatshme për t'iu përgjigjur çdo çështjeje me interes publik, në funksion të mirinformimit të qytetarëve", thuhet në deklaratën e plotë të policisë.

ARRESTOHET BIZNESMENI QË KOMPLOTOI VRASJEN E GAZETARIT RUS

Arkady Babchenko, ka thënë të enjtën se i është dashur të bëjë një veprim të tillë, pasi është frikësuar se mund të përfundonte sikur ish-agjenti rus, Sergei Skripal, që është helmuar me agjent nervor në Britani

Një gjykatë në Ukrainë vendosi masën e arrestit me burg për një biznesmen që dyshohet se komplotoi për vrasjen e një gazetari disident rus. Borys Herman akuzohet se pagoi 15 000 dollarë për të vrarë Arkady Babchenkon në Kiev. Por ai thotë se nuk ka dashur të vrasë askënd dhe thjesht bashkëpunoi me shërbimet e sigurisë ukrainase SBU. Këto të fundit inskenuan vrasjen e gazetarit me pretendimet se shmangën një komplot rus.

Por pasi u zbulua se ishte ende gjallë, Babchenko tregoi se u përdor gjak derri dhe një grimiere për të krijuar skenën e vrasjes së rreme. Sipas Babchenkos, pasi doli lajmi se ai vdiq, biznesmeni Herman i pagoi 15 000 dollarë vrasësit. Por sipas SBU, vrasësi ishte një agjent i saj i infiltruar që më pas shërbeu për të arrestuar biznesmenin.

Ukraina është kritikuar ashpër për inskenim që krijoi dhe kritikët thonë se kjo lëvizje i ka dhënë Rusisë avantazh moral. Vetë Moskë e



përshkroi operacionin ukrainas si një akt provokimi.

Arkady Babchenko, ka thënë të enjtën se i është dashur të bëjë një veprim të tillë, pasi është frikësuar se mund të përfundonte sikur ish-agjenti rus, Sergei Skripal, që është helmuar me agjent nervor në Britani, transmeton Reuters.

Zyrtarët ukrainasë kanaë ra-

portuar në mbrëmjen e së martës për vdekjen e kritikut të Kremlinit në Kiev. Disa zyrtarë të autoriteteve ukrainase kanë pretenduar se Rusia ka qenë mbrapa vrasjes, derisa Moskë e ka kundërshtuar ashpër një gjë të tillë.

Një ditë më vonë Babchenko ka treguar se ka inskenuar vrasjen së bashku me zyrtarë të sigurisë

ukrainase për të dështuar atë që e ka cilësuar komplot të Rusisë për vrasjen e tij.

"Secili thotë se kjo dëmton besimin te gazetaret, çfarë do të bënit ju në vendim tim, nëse ata do të vinin te ju dhe do t'iu godisnin?", ka thënë ndër të tjera gazetari. Babchenko ka thënë se ka menduar të largohet nga Poli Verior në momentin që ka kuptuar planet për vrasjen e tij, mirëpo i është kujtuar se edhe "Skripal ka tentuar të ikë".

Autoritetet britanike kanë thënë se Skripal, ish-agjent i dyfishtë dhe vajza e tij Yulia janë helmuar në muajin mars me agjent nervor të kategorisë ushtarake në Sallsbëri.

Britania fajëson Rusinë për këtë incident, derisa Moskë hedh poshtë vazhdimisht këto akuza.

Prëzohet qeveria spanjolle

Kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy është shkarkuar nga posti pasi mocioni i mosbesimit ndaj tij ka kaluar në parlament. Lideri socialist, Pedro Sanchez, që e ka nisur mocionin, pasi partia e Rajoy u përfshi në një skandal korrupsioni do të bëhet kryeministër.

"Ne do të shkruajmë një faqe të re në historinë e demokracisë në vendin tonë", ka thënë Sanchez para votimit.

Rajoy kështu u bë kryeministri i parë në historinë moderne të Spanjës që rrëzohet me një mocion mosbesimi.

Sanchez siguroi 180 vota, duke marrë mbështetjen edhe të partive të vogla, përfshirë Partinë Nacionaliste Baske, ndërsa 169 deputetë ishin kundër, me një abstenim. Rajoy, që drejton Partinë Popullore, ka mbajtur postin e kryeministrit të Spanjës që prej vitit 2011.

Pas rrëzimit të Qeverisë spanjolle, kreu i Partisë Socialiste të Punës (PSOE), Pedro Sanchez, u zgjodh kryeministër i ri. Kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy është shkarkuar nga posti pasi mocioni i mosbesimit ndaj tij ka kaluar në parlament. Lideri socialist, Pedro Sanchez, që e ka nisur mocionin, pasi partia e Rajoy u përfshi në një skandal korrupsioni do të bëhet kryeministër.

"Ne do të shkruajmë një faqe të re në historinë e demokracisë në vendin tonë", ka thënë Sanchez para votimit.

Arrihet marrëveshja për formimin e qeverisë në Itali

Giuseppe Conte në krye të koalicionit populist Pas disa muajsh të pasigurisë politike, në Itali është arritur marrëveshja për formimin e qeverisë. Mandatari për kryeministër, Giuseppe Conte, i ka prezantuar presidentit, Sergio Mattarella listën e tij të ministrave, për herë të dytë brenda një jave, derisa qeveria e re pritët të formohet të premtën. Ministrat janë zgjedhur nga partitë populiste, Pesë Yjet dhe Liga e krahut të djathtë. Presidenti Mattarella ka kundërshtuar më herët propozimin e Contes për emërimin e euroskeptikut, Pablo Savona në postin e ministrit të Ekonomisë. Ky hap i presidentit kishte nxitur Conten të heqë dorë nga formimi i qeverisë. Të enjtën më pas, të dy janë pajtuar që Giovanni Tria të jetë në krye të kësaj ministrie dhe Conte të tentojë të formojë sërish qeverinë.

Trump e nisi luftën botërore tregtare

Në mesnatë hynë në fuqi doganat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në import të çelikut dhe aluminit nga Evropa, Kanada dhe Meksika, derisa vendet e goditura paralajmërojnë kundërmasa për këtë vendim të administratës së presidentit amerikan Donald Trump.

Sekretari shtetëror amerikan për tregti Wilbur Ross i ka thënë gazetarëve se tarifat prej 25 për qind në import të çelikut dhe 10 për qind për alumin nga BE, Kanada dhe Meksika, do të hyjnë në fuqi në mesnatë (e premtë në orën 5:00 sipas kohës sonë). Presidenti i SHBA ka futur në mars doganat prej 25 për qind në import të çelikut dhe 10 për qind në import të aluminit, por për kohësisht e miratoi përjashtimin nga këto tarifa të BE'së, Kanadasë, Meksikës, Australisë dhe Argjentinës. Presidenti i Komisionit Evropian Jean Claude Juncker ka paralajmëruar se Bashkimi Evropian do të fusë kundërmasa ndaj SHBA, pas vendimit të Uashingtonit zyrtar që të mos vazhdojë përjashtimin e BE'së nga tarifa në çelik dhe alumin, transmeton Insajderi.com.

"Kjo është ditë e keqe për tregtinë botërore. Kështu që menjëherë do të nisim procesin para Organizatës Botërore të Tregtisë dhe në orët e ardhshme do të paralajmërojmë kundërmasat e barabarta", ka deklaruar



Juncker dje në Bruksel.

Pritet që kundërmasat e Bashkësisë Evropiane do ta godasin eksportin amerikan në vlerë prej rreth 7,5 miliardë dollarë.

"Është plotësisht e papranueshme që një shtet të fusë masat e njëanshme kur është fjala për tregtinë botërore", ka shtuar ai.

Sipas fjalëve të tij, fjala është për masën e padrejtë dhe të njëanshme e SHBA e cila është në kundërshtim me rregullat e OBT. Komisio-

nerja evropiane për tregti Cecilia Malstrom gjithashtu ka paralajmëruar nisjen e procedurës kundër SHBA para OBT. Presidenti francez Emmanuel Macron ka deklaruar se vendimi i SHBA të fusin tarifa në import të metalit nga Evropa është jashtëligjore dhe paraqet gabim, derisa kryeministri kanadez Justin Trudeau ka vlerësuar se ato janë të papranueshme dhe ka paralajmëruar masat reciproke të Kanadasë si përgjigje në tarifën amerikane.

“MALLKIMI I PRIFTËRESHAVE TË ILIRISË” I MIRA MEKSI BOTOHET NË FRËNGJISHT

Është vënë në qarkullim për lexuesin e gjuhës frënge nga grupi Hachette, romani historik i Mira Meksit Teuta e Ilirisë, mbretëreshë dhe pirate, priftëreshë dhe dashnore. Ky roman në gjuhën shqipe, i botuar nga Botimet Toena në vitin 2014 dhe i ribotuar në vitin 2015, mban titullin Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë. I rishkruar nga vetë autorja në gjuhën frënge, romani është botuar nga Les Éditions Persée, në kolanën “Arkivat e Kohës”.

Në kopertinën e pasme shkruhet:

“... Por ajo ka ekzistuar vërtet! Autorja i ka kushtuar tetë vjet hulumtimeve që ta ringjallë për ju.

Rreth vitit 230 përpara Jezu Krishtit, Teuta bëhet gruaja e mbretit Agron të Ilirisë. Pas vdekjes së tij, si prijëse e sprovuar lufte, mbretëresha e re do të vazhdojë politikën e tij pushtuese. Në më pak se tre vjet mbretërim, fitoret e saj pasojnë njëra-tjetrën, aq sa nxisin

zemërimin e Romës, ndërsa atë e kthejnë në legjendë në tërë Ballkanin.

Mes ushtarëve pëshpëritet se vetëm një vështrim i mbretëreshës të bën të pamposhtshëm. Përpara martesës me Agronin, Teuta, priftëreshë e madhe e Ilirisë, ishte mishërimi gjysmë-hyjnor i perëndisë-gjarpër Ilirios.

Pirate në fëmijëri, pastaj priftëreshë e madhe, pastaj mbretëreshë pushtojëse, Teuta nuk është më pak grua e dashuruar. Por si mund të pajtohet misioni dhe pasioni, disiplina drastike dhe çastet e ekstazës, mendjekthjellësia dhe lumturia? Kur ende ishte priftëreshë e madhe, ajo shkon të njohë në Dodonë orakullin e Zeusit, i cili do të vulosë fatin e saj. Do të zbulojë në këtë mënyrë e mrekulluar qytete dhe vende që, më vonë, mbretëreshë, do t'i pushtojë.

Midis historisë autentike dhe epopesë homerike në gjininë femërore, autorja ju fton ta ndiqni dhe ta shoqëroni Teutën, të drithërohe-



ni nga emocionet e saj, të fërgëlloni nga frikërat që ka, të përndizeni nga pasionet e saj, të buzëqeshni me humorin e mbretëreshës, të thithni gulfat e aromës së tregjeve dhe të painaireve, të kridheni në traditën dhe zakonet e Ilirisë dhe të viseve përreth asokohe.

Për Mira Meksin shkruhet: Autore poliglotte, Mira Meksi ka sjellë në shqip vepra të shkrimtarëve francezë dhe spanjollë nga më prestigjiozët. Ajo vetë, shkrimtare e suksesshme, e njohur në gjithë Ballkanin, ka marrë për këtë vepër, çmimin më të lartë letrar në Kosovë, një nga vendet e Ilirisë së dikurshme.”

Filmi mbi ditët e fundit të Oscar Wilde



Ka mëse një muaj që ka dalë trailer-i i filmit “The Happy Prince”, që dokumenton ditët e fundit të jetës së shkrimtarit të mirënjohur, Oscar Wilde të përcjella me plot çaste tragjike dhe zemërthyes.

Rolin e Wilde e luan Rupert Everett, i cili po ashtu e ka shkruar skenarin dhe bërë regjinë e këtij projekti.

Titulli i këtij filmi bazohet në koleksionin e tregimeve për fëmijë të shkrimtar irlandez, “Princi i Lumtur dhe Tregime të Tjera”.

Premiera është dhënë më 21 janar të këtij viti, ndërkaq në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jepet në tetor.

“Prishtina lexon” me muzikë e poezi

Për dashurinë e mllëfin ndaj drejtësive – me një gotë verë e muzikë të mirë – u lexuan poezi e fragmente shkrimesh, në mbrëmjen që i hapi rrugë festivalit letrar në kryeqytet. Me libra në sfond u dekorua skena e improvizuar në oborrin e degës përkujtimore të bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në “Toukbahçe”, në të cilën poezia u shkri me muzikën.

Të ndryshme ishin grupmoshat që u ulën përreth skenës së “Prishtina lexon” të hënën mbrëmë. Po aq të ndryshme edhe rrëfimet e poezive dhe pjesëve letrare që u lexuan aty. Muzika i dha ngjyrë “Natës së letërsisë dhe poetikës”, që zyrtarisht hapi festivalin “Prishtina lexon”



që sivjet u organizua nga Komuna e Prishtinës bashkë me organizatat joqeveritare “ETEA”, “Termokiss” dhe “Toka”. Në këtë edicion festa zgjat

shtatë ditë dhe përfshin të gjitha moshat. DJ Oda Haliti e ka nisur e mbyllur me muzikë mbrëmjen.

Të parët që lexuan ishin Flutur Mustafa e Liridon Miftari. Pas tyre, Anna Grace Mullen dhe Mevlud Rahimaj, në version akustik, interpretuan përpunime të hiteve botërore. Sibel Halimi doli në skenë për të lexuar poezi që shpërndanë mesazhe të fuqishme. Edhe Ndriçim Ademaj e Tinka Kurti lexuan poezi. Plator Gashi e Adelina Tërshani e kanë përmbyllur pjesën e leximit të poezive. Agon Ahmeti, nga “ETEA”, ka thënë se “Nata e letërsisë dhe poetikës” i është përshtatur mirë hapjes së një festivali siç është “Prishtina lexon”.

Hashim Thaçi takon tenorin e njohur spanjoll Plácido Domingo



Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka takuar të premtën tenorin nga Spanja me famë botërore, Plácido Domingo.

Thaçi ka bërë të ditur se përveç bisedës së tij të cilën e zhvilloi me Domingon, e ka ftuar për një vizitë në Kosovë, njofton Klan Kosova.

“Në Vjenë takova tenorin dhe dirigjentin me famë botërore nga Spanja, Plácido Domingo. Përveç bisedës së këndshme, tenorin e njohur Domingo, e ftova që ta vizitojë Kosovën, ftesë të cilën e pranoi me shumë kënaqësi. HTH”

Ndërroi jetë publicisti dhe studiuesi i folklorit, Halil Kajtazi

Pas një sëmundje të shkurtër, në moshën 83 vjeçare, ka ndërruar jetë mbledhësi dhe studiuesi i folklorit, shkrimtari dhe publicisti, veterani i arsimit dhe atdhetari i shquar shqiptar Halil (Veli) Kajtazi.

Ai lindi në vitin 1935 në Vitak të Dre-

nicës, ndërsa që nga viti 1951 jetoi dhe veproi në Prishtinë.

Kajtazi la pas vetës mbi 34 vepra të botuara nga lëmi i folklorit, prozës dhe poezisë. Varrimi i të ndjerit u bë të premtën në varrezat e qytetit në Prishtinë në orën 17:00.



300 të papunë pas anulimit të “Roseanne”

Rreth 300 persona kanë ngelur pa punë pas anulimit të serialit “Roseanne” nga ABC. Shumica e vendeve të punës në produksion tashmë janë mbushur për sezonin e radhës, përderisa ekipi i “Roseanne” kanë ngelur pa vend

pune. Një burim brenda ekipit ka thënë se shumica prej tyre kanë shpenzime të larta, dhe se nuk kishin pritur që seriali të ndërpritej pa pritur. Gjithashtu duke marrë parasysh shikueshmërinë e lartë që kishte, diasia nga punëtorët

ishin ndërjerë tejet të sigurt duke shpenzuar shumë, e tani nuk dihet se a do t’ia dalin t’i mbulojnë ato.

“Roseanne” u ndërpre nga ABC vetem disa orë pas komentit racist të Roseanne në Twitter.

VESELI E GJIMSHITI FLASIN PËR NDESHJEN ME KOSOVËN DHE ATË ME UKRAINËN

TË MARRIM PËRGJEGJËSITË TONA DHE TË REAGOJMË!

Një ditë para kësaj sfide kanë folur dy mbrojtësit e qendrës të kombëtares kuqezi, Berat Gjimeshiti dhe Frederik Veseli. Të dy ishin titullarë në ndeshjen me Kosovën, ku kuqezinjtë u mundën thellë dhe luajtën shumë dobët

Kombëtarja e Shqipërisë më 3 qershor do të zhvillojë ndeshjen e dytë miqësore pas asaj me Kosovën në të cilën humbi thellë me 3-0. Kundërshtari i radhës i kuqezinjtë do të jetë përfaqësuesja e Ukrainës. Një ditë para kësaj sfide kanë folur dy mbrojtësit e qendrës të kombëtares kuqezi, Berat Gjimeshiti dhe Frederik Veseli. Të dy ishin titullarë në ndeshjen me Kosovën, ku kuqezinjtë u mundën thellë dhe luajtën shumë dobët. Veseli



ka pranuar se Kombëtarja ishte një ditë të keqe dhe nuk ishin etëm gabimet e mbrojtjes ato që sollën atë humbje turpërore. "Nuk ishte vetëm mbrojtja në ditë të keqe në ndeshjen miqësore me Kosovën. Ishte i gjithë ekipi që luajti keq atë ditë. Kuptohet që është fundi i sezonit dhe ndoshta edhe lodhja bën të vetën, por në Kombëtare të

gjithë vijnë me dëshirë për të dhënë maksimumin. Nuk është se ishte përgatitur keq ndeshja e fundit. Duhet të marrim të gjithë përgjegjësitë tona për atë ndeshje, që duhet harruar sa më shpejt dhe kemi rastin ta bëjmë në miqësoren me Ukrainën. Diskutimet me trajnerin para stërvitjes? Ai gjithmonë në mbledh para seancave

stërvitore dhe na tregojnë për situata të ndryshe në stërvitje dhe në ndeshje. Nuk ka diçka të jashtëzakonshme në këtë rast. Ka pasur gabime në ndeshjen e fundit, por është me rëndësi të reagojmë në vazhdim", – u shpreh mbrojtësi i Empolit në Serinë A. Dëshira për të reaguar pas asaj paraqitjeje shumë të dobët ndaj Kosovës është shumë e madhe te Shqipëria dhe këtë e konfirmoi edhe Berat Gjimeshiti. "Me Kosovën ishte ndeshje e dobët si ajo me Luksemburgun, mendoj se gjithmonë mund të reagojmë, besoj se para startit të 'Nations League' mund të provohet disa lojtarë për të treguar vlerat e tyre. Çdo trajner ka mënyrat e veta për të punuar, tani duhet të lëmë pas Kosovën dhe të bëjmë më shumë me Ukrainën, ka rëndësi të përmirësohemi dhe të reagojmë për gabimet që kemi bërë dhe për tifozët. Ne jemi profesionistë dhe jemi të hapur çdo gjë. Të gjithë lojtarët duan të reagojnë pas figurës së keqe me Kosovën", deklaroi Gjimeshiti.

HAMBURGU
MBLEDH VETEN

Mavraj tani shikohet si shpëtimtar

Hamburgu ra për herë të parë nga Bundesliga pas pesë dekadash. Kjo ka revoltuar drejtuesit e klubit, por natyrisht pakënaqësia ka pllakosur edhe tifozërinë. Lojtari i Kombëtares së Shqipërisë, Mergim Mavraj tashmë ka një shans për të treguar se ky klub ka nevojë për shërbimet e tij. Situata tek Hamburgu ka ndryshuar. Ekipi ka emëruar si drejtor të ri, Ralf Beker, i cili bashkë me trajnerin e ri Kristian Titz po planifikojnë skuadrën për sezonin e ardhshëm dhe sytë natyrisht i kanë hedhur drejt Mergim Mavrajt. "Ne po punojmë me lojtarët që janë nën kontratë. Dua të them se do të ketë një mundësi për Uollas dhe Mergim Mavrajn, të cilët u dërguan në ekipin e dytë kohët e fundit. Të dy kanë kontratë me Hamburgun. Po e shohim situatën me shumë kujdes dhe këta lojtarë meritojnë një shans të dytë"- tha Beker. Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Mergim Mavraj ka një eksperiencë të jashtëzakonshme me Kombëtares, por edhe jashtë saj. Drejtuesit shpresojnë se një marrëveshje me lojtarin kuqezi do ta ndihmonte ekipin në objektivat që do të parashtrihen.



Shkëndija vazhdon bashkëpunimin me katër futbollistë

Shkup, 1 qershor - Skuadra e Shkëndijës ka siguruar vazhdim të kontratës me katër futbollistë që me përfundimin e sezonit 2017/2018 mbetën lojtarë të lirë, njofton klubi kuqezi, transmeton gazeta KOHA. Pas një sezoni historik në të cilin u fitua kampionati dhe Kupa, drejtuesit dhe futbollistët në fjalë gjetën akordin për vazhdim të bashkëpunimit edhe për periudhën që pason, duke firmosur kontrata

të reja. Mbrojtësit Mevlan Murati (tre vite) e Bllagoja Todorovski (1+1), mesfushori Besmir Bojku (2+2) dhe sulmuesi Izair Emini (1 vit) kanë hedhur firmën në kontratat e reja dhe ata do të vazhdojnë përfaqësimin me fanellën kuqezi. Ndërkohë kryesia vazhdon të punojë intensivisht në mbylljen e bisedimeve edhe me lojtarët tjerë, për të pritur pa paqartësi fillimin e përgatitjeve verore.

Adem edhe dy vite te FC Shkupi

Shkup, 1 qershor - Skuadra e FC Shkupi edhe pak ditë numëron deri në grumbullimin e parë, kur më 6 qershor trajneri Zekirja Ramadani do të fillojë përgatitjet me ekipin për fazën e kualifikimeve të Liga Evropës si dhe sezonin e ri të kampionatit të Maqedonisë. Kryesia e klubit këtyre ditëve ka intensifikuar punët me vazhdimin e kontratave me futbollistët të cilëve u kishte përfunduar marrëveshja.

I fundit që ka vazhduar kontratën me klubin është Ermedin Adem, mesfushorin defensivë, i cili është pjesë e Shkupit që nga viti 2015. Adem ka qenë një nga futbollistët kyç të skuadrës në arritjen e objektivit, duke luajtur në 34 ndeshje, ku ka shënuar tre gola dhe tre herë ishte asistent. Ndryshe, marrëveshja e re e Shkupit dhe Adem është arritur edhe për dy vite. Cekim, deri më tani nga futbollistët që

kanë vazhduar me ekipin janë, Suat Zendeli, Muharem Bajrami, Bllazhe Iljoski, Kristijan Stojkoski, Alen Jasharoski dhe Bllagoja Ljamçevski. Ditëve në vazhdim pritet të rinovojnë edhe disa futbollistë, njëkohësisht kryesia është duke punuar edhe në prurjet e reja. Ndërkohë, nga klubi deri më tani janë larguar, Emre Khan-Atila, Shpend Asani, Edis Maliqi dhe Valentin Kočovski.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 167/2015 dhe 27/2016)
Drejtori i NP Ujësllësi dhe kanalizimi – Shkup
publikon

SHALLJE PUBLIKE Për pranimit të punëtorit për kohë të pacaktuar

Publikohet shpallje publike për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendin e punës në vijim:

Sektori “Kontabiliteti, çështje financiare, furnizime publike dhe komerciale”

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës

Kushtet e posaçme:

Të ketë arsim të mbaruar: PSP – shkalla VII – fakulteti ekonomik dhe 3 vjet përvojë pune.

Dokumentet e nevojshme:

1. Fletëparaqitje
2. Certifikatë/Diplomë për arsim të mbaruar
3. Biografi të shkurtë
4. Certifikatë të shtetësisë
5. Dëshmi për përvojë të punës

- Orari ditor i punës prej ora 07:30-15:30.
- Orari javor i punës 40 orë pune (prej ditës së hënë deri ditën e premte).
- Paga bazë është 27.240,00 denarë.

Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë pune llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Nëse në shpalljen publike paraqiten deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ti dorëzojnë në NP Ujësllësi dhe kanalizimi – Shkup në adresën “Lazar Liçenoski” nr. 9 - Shkup.

Telefon për kontakt 02/3073 010 lok. 437; kontakt personi: Ubavka Baçeva;

Në bazë të nenit 19-a dhe 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16 dhe 64/18) dhe nenit 39 të Statutit të komunës së Strumicës (“Fletorja zyrtare e Komunës së Strumicës” nr. 4/03, 2/06, 15/07, 2/10, 21/10 dhe 1/15), publikon

Konkurs publik

Për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të hapësirave për parkim publik “Parkiralishta Strumica” - Strumicë

1. Kandidatët për drejtor të Ndërmarrjes publike për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të hapësirave për parkim publik “Parkiralishta Strumica” - Strumicë, duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të kenë të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit;
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të kenë minimum pesë vjet përvojë pune;
- të posedojnë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

2. Dokumentet e nevojshme:

- biografi të shkurtë (CV - Curriculum vitae);
- certifikatë të shtetësisë
- certifikatë për arsim të mbaruar;
- vërtetim nga organi kompetent se nuk ka ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- dëshmi për përvojën e punës,
- certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet.

3. Konkursi publik zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

4. Dokumentet në lidhje me konkursin publik të parashtrihen në adresën: Komuna e Strumicës, rr. “Sando Masev” nr. 1 Strumicë, me shenjë “për konkurs për zgjedhje të drejtorit të NP “Parkiralishta Strumica” – Strumicë.

Nr. 09-4332/2
01.06.2018
Strumicë

**Komuna e Strumicës
Kryetari i komunës
Kosta Janevski**

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016 dhe 11/2018), Ministria e kulturës publikon:

SHALLJE PUBLIKE Për zgjedhje të drejtorit të Institucionit nacional – Biblioteka Koço Racin – Tetovë

I

- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për kulturë edhe atë:
1. Shtetas të Republikës së Maqedonisë;
 2. Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion penal, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 3. Ka të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror të përcaktuar me statutin e institucionit;
 4. Ka minimum pesë vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër;
 5. Ka një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL iBT – së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS – së paku 60 pikë ose
 - APTIS – së paku niveli B2.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Statutin e institucionit:

1. Ka të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror nga sfera e shkencave shoqërore ose humanistike;

II

Kandidatët për zgjedhje të drejtorit të institucionit duhet të dorëzojnë edhe Program të tyre për punë dhe për zhvillim të institucionit, si strategji për periudhën e ardhshme katër vjeçare (2018-2022), në pajtim me Ligjin për kulturë, si dhe dokumentet në vijim (original ose kopje të vërtetuara tek noteri):

- fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
- dëshmi për së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 të arsimit sipëror nga sfera e shkencave shoqërore ose humanistike;
- dëshmi për minimum pesë vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër;
- certifikatë të shtetësisë;
- vërtetim se nuk ka ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmi për një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL iBT – së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS – së paku 60 pikë ose
 - APTIS – së paku niveli B2

III

Drejtori i cili do të emërohet në periudhën nga dita e futjes në fuqi e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/2018) deri më 1 shtator 2018, obligohet të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti prej ditës së emërimit të tij dhe të parashtrijë dëshminë nga alineja 6 e pjesës së II të shpalljes së publikuar deri te Ministria e kulturës së Republikës së Maqedonisë. Drejtorit të cilit nuk do të përmbushë kushtin e njohjes së gjuhës së huaj në afatin e caktuar nga paragrafi 1 i kësaj pjesë dhe nuk do të parashtrijë dëshminë e kërkuar deri te Ministria e kulturës i ndërpritet mandati.

IV

Shpallja zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet së bashku me Programin dhe dokumentacionin tjetër duhet të dorëzohen në Ministrinë e kulturës përmes postës në adresën: rr. “Gjuro Gjakoviq” nr. 61 – Shkup ose në Arkivin e Ministrisë së kulturës, më së voni deri në ora 16,30 ditën e fundit të shpalljes.

Materialet e dorëzuara në shpallje nuk kthehen.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk merren parasysh.

Për rezultatet e shpalljes kandidatët do të informohen me shkrim.

MINISTRIA E KULTURËS

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 167/15) dhe nenit 82 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 06/12, 100/12, 24/13, 41/2014, 116/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016) dhe në pajtim me miratimin e marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-12420/2 të datës 01.12.2016 dhe Pasqyrës nr. 2 për punësim për kohë të caktuar SHFK “Vera Ciriviri Trena” – Shkup, publikon

SHALLJE PUBLIKE Për nevojë për punëtorë për vitin shkollor 2017-2018

SHFK “Vera Ciriviri Trena” – Shkup për vitin shkollor 2017-2018 ka nevojë për:

1. Mësimdhënës të gjuhës maqedonase - një pozitë për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018. Mësimdhënësi i gjuhës maqedonase është me orar të plotë të punës dhe fond të plotë të orëve (20), prej ditës së hënë deri ditën e premte, me shkallë të VII/1 të arsimit (Mësimdhënësi i diplomuar i gjuhës maqedonase). Mësimdhënësi i gjuhës maqedonase ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 20.644,00 denarë.

Së bashku me lutjen duhet të parashtrihen dokumentet në vijim:

- CV
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- diplomë për arsim të mbaruar përkatës
- të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

Lutjet së bashku me dokumentet të parashtrihen deri në SHFK “Vera Ciriviri Trena” – Shkup, rr. “Rugier Boshkoviq” nr. 9, 1000 Shkup, original ose kopje të vërtetuara në noter.

Telefoni për kontakt: 02/3068507.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 10 ditëve të punës. Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.

SHFK “Vera Ciriviri – Trena”, Karposh

Në bazë të nenit 114 paragrafi 4 alineja 7 dhe nenit 172 të Ligjit për arsim sipëror (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 35/08 me ndryshimet), dhe Vendimeve nga Dekani me nr. 04-535/1/1 të datës 1.6.2018; 04-536/1 të datës 1.6.2018 dhe 04-537/1 të datës 1.6.2018, Dekani i Fakultetit për siguri – Shkup, njësia në kuadër të Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir publikon

KONKURS

Për zgjedhje të:
Mësimdhënësit

- një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat shkencore: Bazat e shkencës së policisë (51609) edhe të Tjera (51610);
- një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat shkencore: Policia dhe të drejtat e njeriut (51608) dhe Bazat e shkencës së policisë (51609);
- një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat shkencore: Teoria e përgjithshme e kriminalitetit (51600) dhe Metodika e kriminalitetit (51601).

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir dhe akteve të përgjithshme të Fakultetit.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shume e të hollave e pagës bazë (në shumë bruto: 56.430,00 denarë) për mësimdhënësin janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimdhënësi.

Fletëparaqitjet të dorëzohen në Arkivin e Fakultetit për siguri, rr. “1” Kolonia Idrizovë nr. 2A, Shkup, me shenjë “Për konkurs”.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë (në tri kopje), dokumente për arsim të mbaruar në original ose kopje të vërtetuara në noter, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe nga një kopje të punimeve të publikuara veças ose në publikim, dhe formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues (Buletini i Universitetit nr. 382 të datës 31.12.2013) dhe vlerësim pozitiv për vetevaluim.

Dokumentet parashtrihen në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Konkursi zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI PËR SIGURI – SHKUP

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr 167/2015, 27/2016) dhe nenit 5, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA Eletranat e Maqedonisë, në pronësi të shtetit Shkup, ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën për lidhje të marrëdhënies së punës nr. 04-3028/1 të datës 01.06.2018

SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË – SHKUP publikon SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës në Drejtorinë – Shkup të SHA ELEM – Shkup, për realizimin e punëve për kohë të pacaktuar, për vendet e punës në vijim:

- 1 (një) realizues në vendin e punës “Kordinator për rregullativë dhe marrëveshje” në Shërbimin për rregullativë dhe marrëveshje, Departamenti për punë normative dhe organe të shoqërisë në Sektorin për çështje juridike dhe të përgjithshme.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojë edhe kushtet e posaçme në vijim: Shkalla VII, Fakulteti juridik, 1 vjet përvojë pune.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 40.305 denarë.

Java e punës është 5 (pesë) ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditëve të punës do të zgjasë 8 orë në ditë edhe atë me fillim prej ora 07:30-08:00 deri në ora 15:30-16:00.

Shpallja zgjatë pesë ditë pune nga dita e shpalljes.

Së bashku me fletëparaqitjen (të shkruar me dorë) në të cilën theksohet se për cilin vend pune konkurrohet, kandidatët duhet të parashtrajnë:

- Dëshmi për arsimin e mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM);
- Certifikatë të shtetësisë (kopje);
- Biografi të shkurtë në gjuhën maqedonase;
- Kontakt telefon.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme, nga të cilat shihet se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të dorëzohen në adresën:

SHA Eletranat e Maqedonisë - Shkup, Drejtoria
rr. 11 Oktomvri nr. 9, Shkup, (me shenjë “për shpallje publike”).

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për mbrojtje sociale (“Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 33/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15,30/16, 163/17 dhe 51/18) nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 të Statutit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale - Shtip dhe Vendimit të Këshillit drejtues nr. 02-626/3 të datës 31.05.2018, Këshilli drejtues i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip shpall:

SHPALLJE PUBLIKE Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip

Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:

1. Të kenë të mbaruar arsimin sipëror të shkallës VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK ose nga profilet arsimore në vijim: punëtor social i diplomuar, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog;
Të kenë minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit;
Me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Të kenë të përgatitur program për udhëheqje me institucionin.
Neto pagesa është 27.231,00 denarë

2. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
- Dëshmi për arsim sipëror të mbaruar përkatës - certifikatë ose diplomë;
- Vërtetim për përvojë pune pas diplomimit;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

3. Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

4. Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

5. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

6. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri tek Këshilli drejtues i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip, në adresën në vijim, rr. “Partizanska” nr. 31-A, Shtip.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale – Shtip
KËSHILLI DREJTUES
Kryetar,

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 74/2015), nenit 80, 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 56/12, 100/12, 24/13, 14/14, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15 dhe 30/16) SHFK “Kiril i Metodi” Sveti Nikole publikon

SHPALLJE PUBLIKE për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar të punës

1. Një defektolog për 40 orë punë deri më 31.08.2018 me pagesë prej 20.644 denarë.
2. Një mësues për 20 orë mësimorë deri më 31.08.2018, gjegjësisht deri në kthimin e punëtorit nga pushimi mjekësor me pagesë prej 20.644 denarë.

Kandidatët duhet të përbushin kushtet të parapara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme të parapara në Ligjin për arsim fillor. Orari i punës prej ora 07 deri në ora 13, gjegjësisht prej ora 13 deri në ora 19.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 7 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

SHFK “Kiril i Metodi”
rr. Angell Trajçev nr. 40 Sveti Nikole
Personi për kontakt Kiro Panev tel. 032/443 110



REPUBLIKA E MAQEDONISË AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nënpusëve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik për mënyrën e punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 68/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Manastirit” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për kontrollin e buxhetit, Sektori për çështje financiare I realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësims strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 28.512,00 denarë

VËREJTJE:

Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) I. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti “Shën Kiril dhe Metodi” – Shkup
Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike



LAJMËRIM

Universiteti “Shën Kiril dhe Metodi” – Shkup, Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike publikon lajmërim se më datë 08.06.2018 në ora 11 në amfiteatrin e Fakultetit, do të mbajë mbrojtje publike të disertacionit të doktoratës me titull “Service të bazuara në përlogaritje në mjegull dhe modele për perceptim të kualitetit” nga m-r Aleksandar Karadimçe.

Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike – Shkup

Shpallje

Shitet shtëpia në Gazi Babë me sipërfaqe prej 100m2, posedon 4 dhoma, bodrum dhe oborr, e rinovuar në gjendje shumë të mirë, çmimi 52.000 euro me mundësi për marrëveshje kontakt tel. 078-353-988

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093



Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk



LEBRON MAGJIK
POR NUK MJAFTON

Golden Stejt fiton pas kohës shtesë

Golden Stejt ka fituar 124-114 ndaj Klivlendit në finalen e parë të plej of-it në NBA, ndeshje e vendosur pas kohës shtesë. Sfida e luajtur në "Oracle Arena" të Golden Stejt ka qenë emocionuese dhe spektakolare, me skuadrat që rivalizuan deri në fund për të fituar, aq sa fituesi u vendos pas kohës shtesë. LeBron Xhejms, me 51 pikët e realizuara sot, tregoi edhe një herë se është një përbindësh, duke mbajtur në lojë skuadrën e tij deri në fund, por kjo nuk mjaftoi. I vetëm ai e pati të pamundur që të mposhtë skuadrën e Warriors. Për miqtë nga Klivlendi u dallua edhe Love me 21 pikë e 13 kërcime, ndërsa për Golden Stejt, si zakonisht, diferencën e bëri treshja Durant-Kurry-Tompson, që së bashku realizoi 79 pikë. I mbështetur edhe nga publiku, skuadra e Warriors arriti të mposhtë miqtë nga Klivlendi, në një takim që ishte shumë i bukur, duke argëtuar fansat. Edhe takimi i dytë do të luhet në fushën e Golden Stejt.

"A do të jetë ai "shefi"? Kjo është një fjalë e fortë, por një "udhëheqës" është ajo që pritët prej tij, brenda dhe jashtë fushës. Ai po arrin pjekurinë dhe dëshiron të bëjë mirë. Por, është, gjithashtu, e rëndësishme që të fokusohet në performancën e tij individuale. Kjo është mënyra më e mirë për të udhëhequr me shembull", thotë Lloris

Pol Pogba është nxitur të rritet si "një udhëheqës" nga bashkëlojtari i Francës, Hugo Lloris, me mesfushorin e Manchester Junajted, që "nuk është më një lojtar i ri". Si një pasuri prej 89 milionë sterlinash, pritët shumë prej tij, si një futbollist që mburret me atributet fizike, për të qenë një nga më të mirët e planetit, por ai që shpesh akuzohet se nuk ka mendësinë e duhur. Pogba ka një mundësi këtë verë për të

SIPAS BASHKËLOJTARIT TË TIJ HUGO LLORIS

POGBA DUHET TË JETË LIDERI RI I KOMBËTARES SË FRANCËS



treguar se mund të jetë një prani yjore, pasi shkon në kërkim të lavdisë globale me kombëtaren e tij dhe po sfidohet për të treguar se është gati të marrë një rol prej lideri te Franca. Portieri i Totenhemit dhe i "Les Bleus", Hugo Lloris, u tha

gazetarëve se Franca po përgatitet maksimalisht për Kupën e Botës 2018. "Pogba nuk është më një lojtar i ri. Ai ka mbledhur përvojë me klubin e tij dhe me ekipin kombëtar. Ka shumë talent dhe kjo etiketë është mbërthyer me të që

nga fillimi. Ai ka pasur një sezon shumë të mirë, edhe pse njerëzit ende debatojnë për këtë. Si futbollist dhe si tifoz i futbollit, mendoj se ai kishte një sezon shumë të mirë. Pol ka dëshirë të shkëlqejë me kombëtaren franceze. A do të jetë ai "shefi"? Kjo është një fjalë e fortë, por një "udhëheqës" është ajo që pritët prej tij, brenda dhe jashtë fushës. Ai po arrin pjekurinë dhe dëshiron të bëjë mirë. Por, është, gjithashtu, e rëndësishme që të fokusohet në performancën e tij individuale. Kjo është mënyra më e mirë për të udhëhequr me shembull", deklaroi Lloris. Pogba ka luajtur 52 ndeshje për Francën deri më sot, duke shënuar 9 gola. Ai ishte pjesë e skuadrës franceze, që arriti në finalen e "Euro 2016".

Milani drejt përjashtimit nga Liga Evropë!

Në ditët në vijim UEFA do të publikojë dënimin për klubin e Milanit për shkelje të "Fair Play financiar". Ky është lajmi i ditës së djeshme nga "New York Times", të cilët shprehen se hetuesit e emëruar për këtë çështje kanë vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga Milani dhe me siguri ata do të kërkojnë përjashtimin nga garat evropiane të kuqezinjve. Sipas asaj që transmeton "Sky Sport" deri më tani nuk ka asgjë zyrtare por pritët vendimi në ditët në vijim, por edhe "Sky" raporton se Milani rrezikon seriozisht përjashtimin nga garat evropiane. Vetëm disa ditë më parë UEFA hodhi poshtë marrëveshjen e propozuar nga Milani, të cilët kërkuan kohë për të mbyllur



shkeljet e klubit në lidhje me "Fair Play financiar". Për këtë arsye, organi i kontrollit të UEFA e dërgoi çështjen në gjykatë, duke nënvizuar një shqetësim të caktuar rreth kushëve të qëndrueshmërisë. Marrëveshja vullnetare e paraqitur nga

Milani në dhjetor ishte një plan shlyerje për të shmangur sanksionet ekonomike. Por Trupi i Kontrollit Financiar e ka përqendruar vëmendjen në pasiguritë në lidhje me rifinancimin e borxhit të kontraktuar me fondin Elliot që do të

zgjidhet deri në tetot të 2018. Çfarë rrezikon Milani? Ekziston një precedent në Evropë në lidhje me këtë procedurë të përdorur nga UEFA dhe i përket Dinamos së Moskës, për të cilët në vitin 2015, nuk u miratua marrëveshja e shlyerjes. Klubi rus u dënua me 4 vjet përjashtim nga garat evropiane. Në këtë drejtim Milani rrezikon një sanksion të ngjashëm, edhe nëse te klubi i Milanos shpresojnë për një ndëshkim më të butë, sërish do të ndikojë aspekte të tjera ekonomike ose bllokimin e merkatos hyrëse. Sidoqoftë gjendja te Milani vijon të mbetet alarmuese dhe lajmet nga SHBA shtojnë më tepër frikën. Në pak ditë UEFA do të shpallë fatin e Milanit.

REINA FLET SI LOJTAR KUQEZI

Rikthimi i Milanit në Çampions, një detyrim

Vetëm fotoja klasike mungon, së bashku me Fassone dhe Mirabelli, për ta parë Pepe Reinën me fanellën e Milanit për sezonin e ardhshëm. I bllokuar prej disa muajsh, me parametër zero, portieri i tanishëm i Napolit është projektuar me krenari për aventurën e tij të ardhshme. "Milani është një nga klubet më të rëndësishme në botë, kush luan aty e ka për detyrë ta sjellë atë përsëri në Ligën e Kampionëve, – shpjegon Reina, i intervistuar nga "AS" – Titullar, apo rezervë e Donnarumma? Nuk bëj më asnjë diskutim të këtij lloji. Unë jam i lumtur për të dhënë fund karrierës time et Mila-



ni. Vendin e titullarit do të duhet ta fitoj ditë pas dite, në çdo stërvitje". Nëse Milani është e ardhmja, Rei-

na është ende kaq blu, teksa kujton momente të paharrueshme dhe sidomos figurën e Maurizio Sarri:

"Duke punuar me të ishte fat. Napoli është në këtë nivel në sajë të punës së Sarrit. Në këto tri vite, Napoli ka luajtur një futboll të bukur. Ne si njerëz duhet të preferojmë t'i themi gjërat në fytyrë. E jona ishte një marrëdhënie mes babait dhe të birit. Unë e dua trajnerin Sarri, do t'i jem përgjithmonë mirënjohës". Nga këtu në sponsorizimin e rëndë është një hap i shkurtër: "Sarri te Real? Unë do ta rekomandoja atë për çdo ekip në botë, për idetë e tij të futbollit dhe për punën e përpiktë". Nuk ka helm për presidentin De Laurentiis, por një fjali, që mjafton për të kuptuar shumë gjëra në lidhje me një

marrëdhënie të përkeqësuar me kalimin e kohës: "Ka një mënyrë për të menaxhuar klubin, që unë e respektoj, por ka gjëra me të cilat nuk pajtohem. Kemi dy personalitete të forta dhe ide të ndryshme". Sa për titullin e munguar, Reina thekson një aspekt të Juventusit kanibal: "Napoli ka mbyllur një kampionat të madh, me 91 pikë, por Juventus ka bërë më shumë. Në nivel të korporatës, forca e Juventusit nuk është e krahasueshme me atë të ekipeve të tjera. Për aq kohë sa Juve do të investojë ashtu siç ka bërë deri më tani, do të jetë e vështirë për t'u mundur në Itali", deklaroi Reina.

DASHI 21. mars - 20. prill
Në dashuri do të shfaqni shumë pretendime dhe kjo gjë, për shkak se po mundohuni të lini pas krahëve të gjitha zhgënjimet me të cilat jeni përballur në të kaluarën. Gjithsesi, mundohuni të mos e vini shumë nën presion, partnerin/en tuaj. Në vendin e punës parashikohen të reja të rëndësishme.

DEMI 21. prill - 21. maj
Kur jeni të përhumbur në mendime, shpesh prirjen të izoloheni, por kjo gjë mund t'iu ndalojë që të hapeni më shumë me personat që ju rrethojnë. Kështu do ju mohohet mundësia për të marrë sugjerime me vlerë prej tyre. Mos e humbni një mundësi të mirë që do ju ofrohet, për të bërë njohje të reja.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Parashikimet e yjeve flasin për një ditë të rëndësishme, e cila iu projekton drejt një vendi intrigues, sidomos sa i takon fushës së ndjenjave. Do të merrni surpriza të bukura, lidhur me një projekt i cili deri më tani nuk iu bindte.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Jini më të komunikueshëm dhe më të gatshëm për të bashkëpunuar në vendin e punës, kjo pasi do të jetë e rëndësishme për ti dhënë jetë një projekti të ri. Sa i takon dashurisë, kjo e enjte nuk do të jetë shumë e favorshme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Do të jeni të shqetësuar për shkak të një sërë çështjesh lidhur me karrierën tuaj profesionale. Mos e humbni durimin lidhur me strategjitë tuaja, por analizojeni me më shumë kujdes, duke ndjekur udhëzimet e bashkëpunëtorëve tuaj. Në mbrëmje parashikohen takime interesante.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Në lidhjen në çift do të jeni shumë xheloz dhe kjo për shkak të disa përgjigjeve që po vijnë. Gjithsesi kjo gjë nuk duhet marrë shumë përpjekur. Megjithatë kjo ditë do të hapë mundësi shumë të mira para jush.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Në lidhjen në çift do të jeni shumë xheloz dhe kjo për shkak të disa përgjigjeve që po vijnë. Gjithsesi kjo gjë nuk duhet marrë shumë përpjekur. Megjithatë kjo ditë do të hapë mundësi shumë të mira para jush.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Mundohuni të mos jeni shumë kritikë ose mendjemadh, pasi në të kundërt rrezikoni të krijoni shumë armiq përreth. Sfidat nuk do ju trembin, por duhet të rrethoheni nga njerëz pozitiv për të kapërcyer pengesat.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Cjatë kësaj të enjteje, mund të tërhiqni vëmendjen e një personi me ndikim, i cili do të vlerësojë cilësitë tuaja. Mos u tregoni të rezervuar në dashuri, si dhe tregoni kujdes me fjalët.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Do të jeni të detyruar të punoni më shumë, për të rregulluar gabimet e kryera nga të tjerët dhe kjo gjë ju shkakton tension të madh. Gjithsesi mundohuni të mos përfshihen nga ankthi sa i takon situatave familjare, apo atyre të dashurisë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Përmbillet një muaj i cili ju sugjeron që të vepromi me më shumë qetësi dhe përqendrim në vendin e punës, sidomos nëse keni nisur negociatat të rëndësishme. Horoskopi i kësaj dite ju fton që të menaxhoni më mirë kursimet tuaja.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Kjo do të jetë një periudhë e shkëlqyer për sektorin profesional, duke arritur të realizoni një sërë projektesh dhe idesh që i mbani në sirtar prej kohës. Në dashuri, këshillohet të mos jeni shumë impulsiv.

Koha Koha	AKTORI AMERIKAN NGA FOTO	SHPREHJE TË VEÇANTA TË NJË GJUHE (gjuh.)	MASË JAPONEZE PËR PESHË	PERSI	KOLEKSI- ONIST, MBLEDHËS	MASË DRITHËRASH (vjet.) (shq.)								
GJESTIKULIMI ME PJESE TË FTYRËS														
BASHKOJ, BËHEM ANËTAR														
JOD, INTENSITET			ALANINA (kim.) E SHPEJTË											
GJUJATA E TOPIT NGA KËNDI (FUTBOLL)														
NËNA				KLINT ISTVUD OREKS										
DELL I FORTË NË MISH (shum.)						KRAHINAT, ANËT (vjet.)								
MALTA ISH FUTBOLL KOLUMBIAN, KARLOS		PIKË NË XHUDO DHE KARATE LYRËSIM, VAUOSJE				NJERI (ang.)					MJETE PUNE	Koha Koha	SHKISHËROJ (fet.)	ISH BASKET- BOLLISTI AMERIKAN, BIRD
												AKTORI, PAÇINO QË I PËRKET DASHURISË		
VOLT DYSHE INTERPRE- TUESISH					MANEKINJA DANEZE, CHRISTENSEN QYTET NË ITALI									
SANDRA BULOK METËR			RRUGËTIM BËRA SI TJETRI											
								FUTBOLLISTI ITALIAN, FRANÇESKO OKTAPODI						
JAM I DENJË TË NDEROHEM MINDER				PËRSËRITET, PËRSËRI (frenqj.) MALLKIMET						SHTAZË NJË- QELIZORE				
	FUND (Ital.) KËNGËTARJA JONË, GJERGJI							KËNGËTARJA SUMAK AMIDON, NISESHTË (kim.)						
JO NATËN							LAKESË, PËRKULJE MASHKULL I DELES							
PËRSHTATJË, RREGULLIM									ZET, ELEKTRON FRANÇESKO TOTI					
							AI QË KA FRIKË NGA BLETAT							
RROFSH (spanj.) BURIMET							LLOJ DYSHEKU QË SHTRONHET PRAN VATRËS OSE MBI MINDER							

FJALËKRYO KLASIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9
10					11			
12				13				
14			15		16			
			17	18			19	
20	21		22			23		
24		25		26	27		28	
29					30			
31				32				
33								

HORIZONTALISHT:

1. Mjek i dhëmbëve; 10. Lloj karroce (vjet.); 11. Këngëtar, Bytyçi; 12. Lythi; 13. Që nuk mund të jetojë pa oksigjen të lirë; 14. Shkrimtar i egjiptit të vjetër; 16. Barkë indiane; 17. Zë i thellë mashkulli; 19. Intensitet, energji; 20. Bardhë (turq.); 22. Tabulator (shkurt.); 24. Pafta a monedha që varin gratë në gjoks për zbulurim; 26. Që lidhet me islamizmin; 29. Gypi i posaçëm që përdoret për drenazhim; 30. Mjet për të shkruar; 31. Pozitë, gradë; 32. Ish futbollisti gjerman, Mateus; 33. Të qenët absolut.

VERTIKALISHT:

1. Picërraku, pikëlorja (zool.); 2. Mjet udhëtimi e transporti; 3. Vendet e gjelbëruara në shkretëtirë; 4. Del një farë e mbjellur; 5. Ad Acta; 6. Appetit; 7. Njësia monetare e Turqisë; 8. Modifikimi alotropik i oksigjenit; 9. Të qenët i gabueshëm; 15. Ish pop grup i njohur Suedez; 18. Liman në Suedi; 21. Mal në Maqedoni; 22. Lloj vallëzimi; 23. Mizë që bën mjaltin; 25. Vlerësim i pasurisë (hist.); 27. Film i shurtër reklamues; 28. Vendës; 32. Lutec.

Diplomon 89-vjeçarja, zotohet t'i vazhdojë studimet master

Ella Washington, 89-vjeçe, nga SHBA-të, ka diplomuar në universitetin Liberty të Virginia, por ajo thotë se nuk e ka ndërmend të ndalet me kaq, pasi dëshiron të vazhdojë studimet dhe të regjistrojë edhe magistraturën. Siç raportojnë mediat amerikane, ajo ishte e martuar shumë e re dhe kishte krijuar familje. Dhe për shkak të angazhimeve të shumta nuk kishte mund të vazhdojë shkollimin, dhe prej atij momenti i kishte mbetur "pikë në zemër". Për shumë vite ka punuar si pjesëtare e sigurimit në Pentagon, dhe më pas është shkolluar dhe është bërë infermiere në domin e pleqve, ku kishte punuar deri para 6 viteve. "Asokohe nuk ka pasur shumë mundësi



punësi për afro-amerikanët, por ajo kurrë nuk u dorëzua dhe punoi punë të ndryshme që të na e sigurojë kafshatën e gojës", ka deklaruar bija e saj Elle Michelle. Ajo ka shtuar se si nëna i kishte mësuar të lexojnë, shkruajnë dhe llogarisin ende pa u regjistruar në shkollë. Ella fitoi diplomën për infermiere në vitin

1978, kur ishte 49-vjeçare, ndërsa gjashtë vite më parë e bija mezi arriti ta bind që të regjistrohet në fakultet dhe të përfundojë studimet online në universitetin Liberty. "E dua historinë, është lënda ime e preferuar. Secili person do të duhej të dinte historinë e tij dhe të mësoj shumë për të", ka deklaruar Washington.

Nuhatësja e vdekjes, "dhuntia" e rrallë e 24-vjeçares

Një 24-vjeçare australiane pretendon se mund të nuhasë vdekjen. Ari Kala thotë se ndjen një aromë si të ëmbël kur qëndron pranë një njeriu që do të vdesë së shpejti. "Shqisa" e saj u zbulua kur ajo ishte në moshën 12-vjeçare dhe vizitoi xhaxhain e saj të vdekur. Ari e përshkruan fuqitë e saj psikike si një "barrë", sepse ajo nuk është në gjendje të shpëtojë jetën e personit që nuhat dhe kurrë nuk i tregon njerëzve që do të vdesin së shpejti, pasi nuk i takon asaj ta bëjë këtë gjë. "Është një dhunti e padobishme, nuk i ndihmoj dot njerëzit", thotë 24-vjeçarja.



Iphone 9 do t'i mposhtë të gjithë

Gjenerata e re e Apple, Iphone 9 mund të jetë shumë më i shpejtë dhe bateria e tij mund të zgjasë shumë më tepër krahasuar me rivalët. Raportohet se Apple ka filluar prodhimin e një procesori të



E groposën kur ishte foshnje, viziton varrin e tij 20 vite më pas

Matthew Whitaker është jashtëzakonisht me fat që sot është i gjallë dhe për jetën e tij i detyrohet Azita Milanian, e cila e gjeti atë të varrosur gjallë në pyll vetëm pak orë pasi u lind, 20 vjet më parë. Tani, Mateu dhe Azita më në fund janë ribashkuar në një takim emocional në Ryan Seacrest, ndërsa hera e parë e tyre ishte dita që mund të ishte fatale për Mateun.

"Ju jeni pikërisht ai që unë kam imagjinuar. Mendova madhësinë tuaj, gjithçka. Faleminderit që erdhët në jetën time, keni ndryshuar jetën time. E dija se do të lidheshim përsëri. Perëndia na solli së bashku për një qëllim". Azita gjeti Mateun ndërsa vraponte në një shëtitje në Altadena të Kalifornisë në vitin 1998. Ai u varros në një varr të cekët, i mbuluar me mbeturina dhe mezi merrte frymë. Ishte një nga qentë e Azitës që dha alarmin pasi këmbët e bebes ishin në sipërfaqe. "Mendova se ishte një kafshë apo krijesë e vdekur", tha ajo në një intervistë në atë kohë. "Pastaj, duke shikuar thellë në pluhur, mund të



shihja se ishte një fëmijë." Ajo lajmëroi një motorist që po kalonte. Shoferi u drejtua në stacionin e policisë lokale, ndërsa Azita qëndroi prapa me Mateun, duke e ngushëlluar dhe duke e pastruar. Mateu mbijetoi dhe u adoptua dhe që prej atëherë Azita nuk e pa më. Nëna që e braktisi nuk u gjet asnjëherë. Mateu nuk mësoi për shansin e tij të pabesueshëm të dytë në jetë deri vonë.

Palët planifikojnë të mbajnë kontakt, dhe Azita më së fundi ishte në gjendje të përmbushë ëndrrën e saj.



fuqishëm që do t'u vendoset telefonave që do të nxjerrë në shitje këtë vit. Lajmi i mirë është se cipi misterioz do të sjellë një revolucion në shpejtësinë e telefonit, si dhe jetëgjatësinë e baterisë.

1619 – Anglia dhe Holanda nënshkruajnë traktat për biznes me indianët.

1676 – Beteja e Palermos: Francëzët i mundin flotën holandeze dhe spanjolle.

1780 – Protestuesit Anti Katolik sulmojnë parlamentin në Londër.

1848 – Fillon Kongresi sllav në Pragë.

1876 - Hristo Botev, revolucionari kombëtar i Bullgarisë vritet në Stara Pllanina.

1901 - Benjamin Adams arrestohet se ka luajtur golf në ditën e diel.

1904 – Profesori Shron gjen mikrobën i cili shkakton fotosintezë.

1955 – BRSS dhe Jugosllavia nënshkruajnë Deklaratën e Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve.

1979 – Papa Xhon Pali II viziton Poloninë.

1997 – Liberalët mundin Konservatorët në Francë.



Me vite të tëra jetojmë në lajthitje se cila shtypje e gjakut është normale dhe kur është koha për panik. Mësoni cila është "normalja" e re. Secili i cili kurdoherë ka pasur nevojë të matë shtypjen e gjakut, e që çdo gjë është në rregull kur i sipërmi është 120, ndërkaq i poshtëmi rreth 80. Çdo gjë më shumë, paraqet alarm dhe menjëherë shkohet për kontroll tek internisti apo te kardiologu. Nëse është më ulët, e di që është koha për sheqer dhe ujë apo për një filxhan kafe. Mirëpo, tani çdo gjë ka ndryshuar. Shoqata Evropiane Kardilogjike ka dhënë udhëzime të reja, sipas të cilave normale për shtypjen sistole deri në 140, ndërkaq për atë diastole 90. Mirëpo, kjo rregull nuk vlen për të sëmurët me diabet, për të cilët kufiri është më i ulët, deri 130 me 80, si edhe te popullata e moshuar.

DASHURIA

- Arta, jam çmendur pas teje.
- Mirë, mirë, por rri larg babait tim.
- Pse, është i ashpër me djemtë që të vijjnë rrotull?
- Jo, por është drejtor i Spitalit Psikiatrik.



Çfarë është jeta? Të rrëzohesh shtatë herë dhe të ngrihesh tetë herë.

(proverb japoneze)



KALENDARI HISTORIK 2 QERSHOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS